

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME SAMI SHATRIN

Prishtinë | Data: 25 mars, 2023

Kohëzgjatja: 151 minuta

Të pranishëm:

- Sami Shatri (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Sami nëse mundeni me u prezantu, datën e lindjes, vendin edhe diçka për prejardhjen e kuj?

Sami Shatri: Unë jam Sami Shatri, Sami Selman Shatri, për arsye se janë nja tre-katër Sami Shatri, p'e ceku emrin e babs. Kom lindë me 15 nëndor 1964 në fshatin Tomoc, komuna e Istogut. Jom njëri nga fmitë e Selman Shatrit për arsye se ai i ka pesë fmi. Dy vajza edhe tre djem, tre vllazën. Prejardhja jonë si familje e në përgjithësi e Shatrave është nga Isniqi, nga fshati Isniq. Mandej kanë kalu në Tomoc. Pra, ni pjesë e tyne, i pari jonë Shatri, ka, ka qenë me vendbanim në Tomoc ndërsa pjesa tjetër në Boletin. Familja Boletini është degë e familjes sonë. Pra, jemi faktikisht të një gjaku.

Në përgjithësi unë do t'isha nalë prej në periudhën prej vitit 1949 e knej. Për arsye se edhe përpara është ni pjesë e historisë, të cilën unë fort nuk... po nga viti '49 e knej. Baba im Selman Shatri ka pasë dy vllazër. Dy vllazër nga nëna, jo nga babai. Nuk ka pasë motër, u konë fmi i vetëm. Baba e ka lanë në moshën dy vjeçare. Qysh ka qenë tradita n'atë kohë, domethonë, mas vdekjes së babait nana, gjyshja jeme, Zejnepja, është kthy atëherë i kanë thanë që është kthy është martu për kunatin, Ahmet Shatrin, i cili pastaj n'atë kohë ka qenë edhe i fejun me Zelfijen ku ma vonë është martu edhe me Zelfijen. Pra, ka pasë dy gra. E babai im ka qenë i Zejnepës.

Gjithashtu edhe vëllezërit e tina, Saliu i cili tash në vazhdim e përmendi si osht' historia e tina, dhe Isai kanë qenë vëllezër nga nana. Gjithashtu Ahmeti ka pasë edhe ni vajzë po ka pasë me grunë tjetër, Mihanja, që ka qenë vajza e tina. Krejt historia fillon e familjes sonë fillon me historinë e Sali Shatrit. Sali Shatri domethonë axha im ka qenë në shkollë, atëherë në shkollë normale. Normalja ka qenë në Pejë e mandej ma vonë e kanë transferu normalen nga Peja në Gjakovë.

N'kohën e prishjes së marrëdhanieve Jugosllavi-Shqipëri, domethonë mas Luftës së Dytë Botërore presioni i UDB-së ka qenë sidomos te njerëzit ma t'shkollun n'atë kohë, që kanë qenë shumë pak. Në mënyrë që m'i përvetësu si bashkëpunëtor të tyre. Aty ka lind ideja e Sali Shatrit dhe disa shokve tjerë që mos t'bohen bashkëpunëtor të Sigurimit të Jugosllavisë por e vetmja rrugë ka qenë që të dalin në Shqipëri. Nga atje të zhvillojnë aktivitetin e tyre për, n'atë kohë, për çlirimin e Kosovës. Për përgatitjen që me ni periudhë ma t'vonshme të bohet organizimi i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

Domethonë arratisja ka qenë në vitin 1949, ka ndodhë në vitin 1949 dhe meniherë pas arratisjes së Sali Shatrit në Shqipëri dhe kanë fillu masat represive të pushtetit ndaj familjeve të të cilëve djemt ose vëllezërit kanë dalë në Shqipëri. Asisoji kem përjetu edhe ne. Meniherë domethonë kanë ardhë, kanë rrethu shpinë, kanë kry bastisjen edhe kanë arrestu n'atë kohë Ahmet Shatrin, domethonë babën e Sali Shatrit, Isa Shatrin, vllaun e Sali Shatrit edhe babin tim i cili ka qenë i sëmurë. Domethonë nuk ka dëgju mirë.

Ka qenë i sëmurë nga moshja dy-tre vjeçare e n'atë kohë ndëgjimi ju ka keqësu shumë. Ato e kanë lshu, s'e kanë majtë në burg shumë, e kanë lshu. Po është burgosë edhe nana e Sali Shatrit. Bile thuhet aty që kom ndëgju prej, prej ma t'vjetërve që ajo ka qenë n'bjeshkë edhe prej bjeshke e kanë marrë dhe e kanë burgosë në Burgun e Gurakocit...

Anita Susuri: N'stane ka qenë?

Sami Shatri: Po, në stane. Po që zakonisht kanë dalë verës me bagëti dhe prej atjehit e kanë marrë policia dhe e kanë çu në burg. Pse ka ndodhë mandej ky, ky, ky shfrenim i pushtetit? Për arsye se Sali Shatri edhe disa shokë tjerë kur kanë shku në Shqipëri atje nuk kanë shku si emigrant që të rrijnë në Shqipëri por kanë fillu aktivitetin e tyre. Në mënyrë që të bohen përgatitje të popullit që në ni periudhë të cakune t'i kërkojnë t'drejtat e tyre.

Pra, flasim për ni periudhë tepër dëshpëruese, tepër trishtuese. Osht' koha mas shtypjes së kryengritjes së Shaban Polluzhës në Drenicë, osht' koha pas mbledhjes së procesit të Prizrenit ku me dhunë vendoset që Kosova t'i aneksohet Jugosllavisë. Populli ka prit që Kosova të jetë pjesë e Shqipërisë qysh ka qenë. Ajo nuk ka ndodhë. Atëherë ka qenë ni dëshprim i madh, ni ndjekje e madhe masive sidomos te familjet që kanë pa që mund t'bojnë rezistencë në të ardhmen. Pra, familjet që kanë pasë t'shkollun, familjet e mdhaja që e kanë pasë edhe ni t'kalune patriotike ksi soji.

Aktiviteti i parë i grupeve diverzante, për arsye se në Shqipëri atje e kanë formu grupin diverzant i cili ka pasë për detyra të caktune që të vijnë në Kosovë edhe ta ngjallin shpresën. Atë shpresë të humbur, atë shpresë të thyne dhe ta ngjallin shpresën, të punojnë te njerëz, te familje të caktune. T'u thuhet që do t'vijë ni ditë që Kosova duhet të dalë nga kthetrat e Serbisë por duhet t'punohet. Aktiviteti i tyre ka qenë, aktiviteti i tyre ka qenë shumë, shumë konspirativ. Domethonë tepër sekret, tepër i msheft.

Për arsye se na duhet ta dijmë, ka qenë koha e Rankoviqit¹. Ni kohë që ka pasu me masa tepër represive, aksioni i armëve. Pra, osht' dashtë të zgjidhen njerëz e caktun, njerëz me prirje patriotike në mënyrë që të mos dekonspirohen. Domethonë, n'atë kohë grupet diversante kanë dalë, kanë pasë

¹ Aleksandar Rankoviq (1909-1983) ishte hero partizan serb i cili mori pozitën e Ministrit të Punëve të Brendshme në Jugosllavi dhe ishte udhëheqës i Inteligjencës Ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore. Ai krijoi një sistem terrori në Kosovë, pasi që e konsideronte atë si rrezik për sigurinë e Jugosllavisë nga 1945-1966, kur dhe ai u largua nga Lidhja Komuniste.

kontaktet me familje t'caktune. UDB²-a ka bo punën e tyre, nuk ka mujtë t'i fus n'dorë por e ka ditë që ata dikush i man. E ka ditë që ata kanë, ata duhet të ushqehen, duhet t'vijjnë, kanë kontakte me dikond.

Në këtë mënyrë për ta prerë këtë kontakt kanë burgosë anëtarët e familjes të t'gjithë ktyne që kanë qenë anëtarë të grupeve diversante. Ksi soji mixha, domethonë Isai, që ka qenë ma i vujtni prej t'gjithëve. Për arsye se edhe ai ka qenë anëtarë i ni grupi atëherë n'atë kohë, n'atë kohë janë burgosë. Pas burgosjes meniherë ka ardhë masa tjetër e internimit. T'u pa UDB-a që nuk po mund t'ju pret rrugën e kontakteve të tyre atëherë ka vendosë që kto familje t'i hjek krejt prej Kosove me ni masë të caktune.

Ksi soji, qysh tregojnë, domethonë qysh m'ka tregu baba, mixha, mixha i babs, mandej gjyshja. Unë gjyshen s'e kom mrrri po kjo gruja tjetër që ne i kem thanë nanë për arsye se ka qenë ni gru e jashtëzakonshme. Osht' ardhë urdhni që këta të shpërngulen prej shpisë tynë. Mirëpo këta s'e kanë ditë që ku po shkojnë. Faktikisht veç ka shku policia u kanë thanë që bonu gati, nuk do t'jeni ma ktu dhe me tren nga Peja domethonë deri në Pejë i kanë çu me naj kamion, kamionetë. Nga Peja me tren kanë shku për në Banat në internim. Në vjeshtën e vitit, m'duket të vitit 1950. E përmend edhe [Meriman Braha](#) aty.

Tash n'atë familjen tonë, e kanë pru ni serb. Ni serb thojnë nga Vojvodina. Bile e përmendshin ata baba e mixha, Vuksan e kish pasë emrin. Ai osht' vendos aty me familje t'vet. N'atë kohë kur osht' shpërngulë familja tregojshin që ka qenë vjeshtë, domethonë e kanë kry t'korrnin kanë pasë bereqet shumë. Na si familje kem pasë 14 hektar tokë. Domethonë, kem pasë ni pasuni t'patundshme bukur t'madhe. Ajo ka qenë e punune krejt e kanë lanë dikund 15 krerë bagëti edhe aty e kanë pru ni serb. Kta janë shpërngulë për Banat.

Si, si e kanë gjetë domethonë atë vend, Banata ka qenë ni vend i panjohur për këta. Tregojshin, tash unë po flas me fjalë t'tyne të bab's e të mixh's, që kur kanë shku aty i kanë sistemu me ni stallë të bagëtive. I kanë sistemu bashkë me tri familje tjera. Domethonë familjen Braha, familjen Morina të Pejës edhe familja tjetër e Pejës Trasha m'doket ashtu me mbiemër kanë qenë. Ata kanë qenë të sistemum me ni hapësinë 25 metra deri në 30 metra katror të gjithë aty.

Familja jonë nuk ka pasë fmi. Domethonë se kto familje që kanë pasë fmi kanë hjekë edhe ma keq për arsye se n'kushte tepër t'rana, n'kushte të bagëtive. Për shembull, familja e Meriman Brahës ka pasë shumë fmi, ka qenë ni familje e madhe. Aty i kanë sistemu dhe kanë fillu të punojnë në ni kooperativë bujqësore.

Anita Susuri: E para se me vazhdu, familja Shatri e juja, sa anëtarë kanë qenë atje edhe çfarë mosha?

² *Uprava državne bezbednosti*. Administrata e Sigurimit të Shtetit, i njohur gjithashtu si Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, ishte organizata e policisë sekrete të Jugosllavisë gjatë viteve 1946-1991.

Sami Shatri: Ka qenë mixha i babs Ahmet Shatri domethonë me dy gra dhe me Zejnepen edhe Zelfijen. Ka qenë baba jem, Selman Shatri edhe Isa Shatri. Pra, këta kanë qenë. Vajzën Ahmeti n'atë kohë e ka pasë të martune, ajo domethonë ka qenë e martune në Istog të Poshtëm te familja Buleshka. Ajo nuk ka shku në internim. Kushtet qysh kanë qenë në atë kamp, veç dihet kushte të kampit. Kushte jashtëzakonisht të vështira, puna jashtëzakonisht e randë. Tanë ditën në punë në bujqësi. Atje, kanë gjetë shumë gjerman.

Ai vend kish qenë i banun me gjerman. Dikund thuhet rreth 1 milion gjerman. Ajo ka qenë si provincë bile njihet edhe historikisht. Mirëpo kur kanë hup luftën gjermanët, Luftën e Dytë Botërore, ata i kanë persekutu. Domethonë të gjithë mashkujt gati janë pushkatu. Ni pjesë e tyre osht' transportu në Rusi atje edhe aty kanë mbetë n'atë kamp kanë mbetë shumë femra, me mijëra femra edhe fmij t'vegjël.

Tregojshin baba edhe mixha kur na kanë çu s'pari n'punë, na kanë çu në ni hangar të madh që kishin qenë duke e hjedhë grunin, duke e pastru grunin aty ato gjermankat. "Kur kemi shku", tha, "na si t'ri" domethonë baba ka qenë rreth 30 vjet ndërsa vllai i tina Isai rreth 20 vjet qashtu. Ata të ndrojtun nuk ishin msu me pa vajza në fustana, ktu ka qenë ndryshe në Kosovë në atë kohë.

"Po rrijmë", tha, "aty. Ato", tha, "po thojnë n'gjuhën serbe që duhet për me punu ktu. Na", tha, "i kishim do shamija n'kokë", qashtu ka qenë si traditë, floktë të rruhen krejt edhe të vendoset ni shami n'kokë edhe plisi. "Atëherë", tha, "njana prej tyre na ka hjekë ato shamija edhe tani kem fillu", tha, "m'u shoqëru me to. Shumë njerëz t'mirë vijshin aty ku ne rrishim. Kishim muhabet".

Bile kanë pasë lidhje edhe mas kthyrjes nga kampi domethonë n'shpi. Ka pasë ardhë ni letër e tyre tregojke mixha. Që ni grup i tyre ka pasë fatin t'shkoj në Gjermani. Mirëpo ni pjesë e madhe e tyre u mytshin në Danub, tregojshin ata. Nuk muj e durojshin atë gjendje dhe provojshin fatin që përmes Danubit t'kalohej kufiri dhe i gjojshin të mbytur në Lumin Danub.

Anita Susuri: Ato krejt gjermane kanë qenë?

Sami Shatri: Të gjitha kanë qenë gjermane, domethonë. Ksi soji ata kanë nejt gati tri vjet, ashtu në Kampin e Banatës, në kamp të internimit. Mandej me ni vendim të shtetit janë kthy në shpi. Mirëpo problemi ka qenë se internimi nuk ka pasë afat. Pra, kur kanë shku këta nuk e kanë ditë sa i majnë. Se burgimi e ki ni afat, i ki katër vjet, i ki pesë vjet. I pret ato pesë vjet edhe e pret datën kur ki për m'u kthy n'shpi, ai nuk ka pasë afat. Domethonë këta tanë kohën kanë nejt në stres se a do t'kthehen naj herë në Kosovë.

N'atë kohë babai im ka qenë i fejun, ka qenë i fejun me nanën. Nana osht' bijë e Istogut, bijë e familjes Sadikaj. Pra, familja e tyre i ka trojet te Trofta, ku osht' Trofta në Istog. N'atë kohë kanë pasë mulli që ka qenë ni aset ekonomik shumë i mirë. Për atë arsye kanë pasë gjendje ekonomike t'mirë. Mirëpo çka

ka ndodhë? Ata si familje i ka godit tuberkulozi, TBC-ja. Se atëherë ka qenë n'qat' kohë e shprehun kjo sëmundje. U ka marrë jetën shtatë anëtarëve të familjes për tri vjet, tregojke nana.

Domethonë baba, nana, vllau 20 vjeç ka qenë, motra 18 vjeç, kunata gruja e vllaut se ai kish qenë i martun, ajo ka qenë kusherin e jona. Ksi soji shtatë... po edhe kunata tjetër e vllaut t'madh. Shtatë anëtarë t'familjes. Nana ka mbetë 14 vjeç edhe fmitë tjerë kanë qenë ma t'vegjël. Vllau madh nantë vjeç deri te fmija dy vjeç. Mandej ksaj i kanë mbetë që t'i kqyrë...

Anita Susuri: Kjo ka mbetë ma e madhja.

Sami Shatri: Ka mbetë ma e madhja, ka mbetë ma e madhja n'familje edhe i ka mbetë domethonë mixha gjallë. Po mixha nuk ka pasë trashëgimtar, nuk ka pasë fmi. Tregojke nana, kur kanë qenë këta në internim, e kanë diskutu baba i saj që ka qenë gjallë me mixhën e kanë diskutu që ta prishin fejesën. Për arsye se nuk kanë ditë kur kthehen. Edhe e kanë diskutu ata n'mes veti po për mos m'u prish fejesa, kanë nigu ni kusheri i tyne që kish pasë ardhë n'atë kohë te Nimush Shabani, te mixha i babs, mixha i nanës edhe natën, se e ka çu dikush.

Ka thanë, "Nimon, me më nigu mu e prish martesën ata kanë djalin në Shqipni, ai osht' oficer atje krijon probleme". Ai Nimoni kish pasë thanë, "Kqyre", thotë, nuk po jep emër kush ka qenë ai, kusheri i tyne. Thotë, "E kom pasë ndërmend për me prish këtë fejesë po", thotë, "masi erdhe ti", thotë, "e m'i the kto fjalë", thotë, "ajo fejesë nuk priset kurrë. E", thotë, "po a ma mirë me pasë djalin në Tiranë oficer a shërbëtor në Beograd". Që ai kusherini që kish pa ardhë e kish pasë ni vlla që e kishin pasë shku në shkollë potilike në Beograd atëherë i kanë çu. I thotë qashtu, "A ma mirë me pasë në Tiranë", thotë, "djalin oficer", thotë, "a shërbëtor në Beograd". Nuk priset fejesa.

Kur kthehen nga internimi, baba me nanën martohen në vitin 1955. Atëherë bohet martesë dhe mandej lindim ne. Domethonë motra e madhe Hyrija, mandej Shabani vllau i dytë, unë i treti, Dija motra e katërta edhe Merimani vllau i vogël, i cili e mban emrin e Meriman Brahës. Atë emër e mban. Ka qenë atë natë kur ka lind vllau im, Meriman Braha ka qenë te na mysafir. M'kujtohet si sot ka qenë me Isa Demën edhe ai ka qenë i burgosur politik që ka vdekë në ni aksident me veturë m'duket në rrugë të trenit. Ni Zymberaj ka qenë, emri nuk m'kujtohet, mbiemri Zymberaj. Kanë qenë mysafir atë natë. Atë natë m'kujtohet ka pasë vdekë Kardelj, Edvard Kardelj³. Në televizion t'u i pa lajmet, u diskutu që ka vdekë Kardelj.

³ Edvard Kardelj (1910-1979), ishte politikan slloven dhe punëtor shoqëroro-politik i RSFJ-së. Kardeli është bërë i njohur për publikun gjithshqiptar me rastin e dekorimit të tij nga ana e komunistëve në Shqipëri, me "Urdhrin e Flamurit".

Ata diskutojshin që Kardelj ka qenë njëri ndër idiatorët për me i nda viset shqiptare në Jugosllavi. Se niherë domethonë në fillim Titoja⁴ ka dashtë m'i lanë si edhe shqiptarë në Maqedoni edhe në Preshevë edhe në Mal të Zi si grup i veçantë, jo i ndam. Po Kardelj kish qenë politikan shumë i meçëm edhe i thotë që me i lanë këta bashkë këta krijojnë probleme. “Kta duhet m'i nda, m'i shpartallu në mënyrë që me ua kompliku situatën kur kërkohet bashkimi duhet me u prish pesë shtete për m'u bo bashkë”. Unë ata i nijsha s'e kom ditë këtë. I nijsha t'u bisedu edhe nifar' mënyre ata e shprehin nifar' gëzimi që ka ndrru jetë Kardelj. Pra, atë natë ka lind vllavi im dhe na në shenjë respekti ia kem lanë emrin e Merimanit. Sot e ka emrin, osht' në Austri, ksi soji. Pra...

Anita Susuri: Po du m'u kthy pak te rrëfimi i kampit përqendrimit...

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet që ju ka tregu baba edhe diçka ma shumë për shembull për kushtet? Për mënyrën e ushqimit? Për kohën e kalune? Për kohën atje?

Sami Shatri: Po, n'fillim n'fillim u kanë shumë vështirë. Mas ni kohe, mas ni kohe këta për ushqim nuk kanë hjekë keq për arsye se kanë punu vet. Domethonë ato kanë qenë produkte bujqësore ku aty ka pasë gjithçka. Thonë që kanë kultivu me grun, me misër, me... kanë mbajtë shpezë, e kanë majtë derra, kanë majtë lopë e. Ma vonë nuk kanë hjekë keq për, osht' fjala për ushqim. Fillimi ka qenë i vështirë, viti i parë sidomos ka qenë i vështirë. Kushtet kanë qenë kushte t'kampit, kushte n'atë kohë shumë t'vështira.

Mas problemi ka qenë që kanë qenë në ni hapësinë t'vogël shumë anëtarë, katër familje. Që osht' dashtë me mbijetu, puntë kryhen. Përsekutime nuk ka pasë, është fjala ma vonë, fjala me, persekutime tjera n'atë aspektin e torturës e sene. Po ka qenë kamp i cili u dashtë t'punohet tanë ditën për ni kafshatë buke...

Anita Susuri: Ata kanë qenë me ni rreth edhe nuk kanë pasë t'drejtë me dalë diku?

Sami Shatri: Po, nuk kanë pasë. Lëvizjet i kanë pasë t'kufizune, t'kontrollune strikt për ni shkumje në Beograd për ndonjë arsye u dashtë të marrin përgjegje prej përgjegjësit të kampit mandej të nënshkruhet ni letër të shkohet me atë letër, t'kthehet prap. Ka qenë e kontrollune gjithçka. Edhe pse rrallë i kanë lanë me shku veç për ndonjë arsye tepër, tepër të fortë.

Anita Susuri: E a kanë pasë kontakt me atë vllaun në Shqipni që ka qenë?

⁴ Josip Broz Tito ishte udhëheqës politik jugosllav që shërbeu si president i Jugosllavisë nga viti 1945 deri në vdekjen e tij në vitin 1980. Ai luajti një rol të rëndësishëm në bashkimin e grupeve të ndryshme etnike të Jugosllavisë, dhe udhëheqi vendin gjatë një periudhe relativisht stabile, duke zbatuar një formë unike të vetëadministrimit socialist të cilin e zbatoi si një aspekt themelor të sistemit ekonomik dhe politik të Jugosllavisë.

Sami Shatri: Tash, koha kur kanë qenë në kampe nuk kanë pasë ndonjë kontakt. Se ka qenë e pamundshme të kontaktohet atje. A koha kur janë kthyer domethonë edhe para se me shku kanë pasë kontakte sidomos Isai, vllau i tina që ka qenë edhe ai i angazhuan. Kanë pasë kontakte. Kontakte ilegale tepër sekrete. Bile unë i di disa raste që i dijnë edhe familja jeme që kur ka ardhë niherë ka ardhë ata zakonisht kanë ardhë edhe ditën tërë kohën kanë nejtë mshefur, kontaktet janë bërë natën.

E gjithmonë i kanë pasë pikat e caktune ku t'lajmërohen e nga aty tani të krijohen kontakte tjera. Niherë tregojshin që janë hetu. Kanë qenë mbi Tomoc, mbi katunin tonë është ni kodër atje, ka pasë grun të mbjellun shumë. Ata kishin qenë dy s'bashku me Ajet Haxhiun që e ka pasë baxhanak. Ajet Haxhiu është edhe autori i disa librave, autori i librit Shota dhe Azem Galica, autori i librit Hasan Prishtina. E kanë qenë të strehun në grun edhe në mënyrë që ditën t'rrijnë aty dhe natën t'i krijojnë kontaktet që kanë pasë detyrat e caktune.

Ni serbe, vendore që ka qenë aty, me ni qen t'vogël duke shku asajde rrugës, qeni i heton edhe leh. Leh në drejtim të tyne. Shkon e n'atë kohë të gjithë serbët e kanë ditë për grupet diverzante. Sidomos në komunën e Istogut dhe e kanë ditë emrin e Sali Shatrit. E kanë laku atë emër. Ajo shkon mas, mas atij qenit që e ka pasë dhe kur ofrohen afër, kur ofrohen afër ata për t'i tregu që mos u ofro shumë, i tregojnë automatikun asaj. Ajo kthehet meniherë. Fati si del n'rrugë vjen ni kamionetë aty edhe e nal edhe shkon në Gurakoc. Shkon në Gurakoc edhe lajmëron.

Ata e kanë ditë kush munet me kanë, meniherë lajmërojnë Istogun. Istogu Pejën dhe vëhet në lëvizje ushtria. Fati që kish qenë ora dikund kah tre masdite dhe këta e lshojnë atë vend meniherë nisen kah Istogu atje kah janë bjeshkët. Por, i rrethojnë. Arrijnë t'i rrethojnë ushtria. Fati bohet mbramje, domethonë për pak bohet mbramje dhe ka pasë tregu edhe Ajeti edhe Saliu pastaj që kanë qenë të strehun shumë afër kamionit të tyne. Që ata s'e kanë bo mend që ata janë kaq afër. Me ni shkurre ashtu kanë qenë.

Në mramje, ata kanë qenë të ushtrun mirë, kanë qenë diverzant, dhe në mramje kur osht' bo terr kanë kalu me, domethonë, t'shtrin barkaz nëpërmjet ushtarëve që kanë qenë edhe kanë shpëtu. Domethonë është njëri prej rasteve që kom ni shumë herë. Rasti tjetër që kom dëgju prej Sejdi Shatrit, domethonë osht' djali i mixhës të Sali Shatrit, Emin Shatri edhe ai është djali i mixhës të Sali Shatrit që i kanë marrë, osht' ardhë shefi i policisë të Istogut, nifar' Stanisllavi e kishin pasë qujtë. Edhe i ka mbledhë krejt anëtarët e familjes, t'afërmit e Sali Shatrit. Domethonë djemtë e mixhës t'tina edhe ia kanë dhanë kah ni ushtarë vendor serb.

Ushtari i armatosur këta t'pa armatosur edhe i kanë qit' me lypë Sali Shatrin. Sigurisht kanë pasë informatë që ai gjindet ksajde. Dhe tregojshin ata, ka qenë vjeshtë, osht' koha kur është korrë misri dhe janë konë ato tubat e misrit të vendosne. "Shkojshim", tha, tregojke ai mixha Sejdi, djali i mixhës t'babës, "me ni serb vendor", tha, "m'thojke 'Sejdi edhe nëse sheh dikund mos bo zo se na vret ai',

kalon rasti”. Kanë lypë deri n’mramje po çfartë ku me gjetë. Janë kthy në bazë ktu. Domethonë ai ka qenë që e mbaj mend që e kanë tregu kshtu.

Mandej ka pasë shumë raste që janë rrethu, ka pasë luftime për shembull këta e përshkrun Mehmet Musa, Mehmet Musë Bala, në Facebook osht’ ka qenë edhe në disa gazeta. Titulli është “Sali Shatri trim tribon i shqiptarisë”. Ku shkruhet se ai Mehmet Musa ka qenë veprimtar dhe n’këto grupet ilegale dy herë ka nejt në Tiranë te Sali Shatri kah dy javë. Ai tregon që rastet konkrete, për shembull, kur janë rrethu te kazerma Millodin Popoviq në Pejë dhe janë vra ushtar dhe ni oficer serb.

Mandej osht’ ni tjetër që është lajmëru që na këta si kem njoftë po përmes Facebook nifar’ Halil Cacaj edhe ai inxhinier i ikun në Shqipëri. Që tregon ni rast tjetër në shtëpinë e Ibush Dushkut, rrethi i Gjakovës, që janë rrethu edhe aty. Edhe aty kanë pasë sukses dhe kanë qenë tre anëtarë t’grupit. Kanë pasë sukses që t’dalin nga rrethimi. Aty ka mbetë i vram ni serb dhe ni shqiptarë. Ni shqiptarë që ka qenë me forcat policore serbe.

Pra, ka edhe raste tjera të cilat janë të evidentuara që na vet s’i kemi ditë po që njerëzit bashkëpunëtorët e tina gjatë shkrumjes të ktyne artikujve në Facebook janë lajmëru me komentit e tyre që unë e kom njoftë, kom qenë, për shembull, ata kanë vepru edhe me Dervish Shaqen. Edhe Dervish Shaqa edhe pse njihet si rapsod ai ka qenë i angazhun në grupet diverzante. Mandej Qerim Uka, mandej Avdullah Zeneli, Berisha njo mbiemrin, Ramadan Shala. Ka shumë të atij grupit. Pra, kto ishin ato aktivitetet e tina.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Nëse mundeni me na tregu për punën që e ka bo mixha juj...

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: Do të thotë në Shqipni edhe a ka ardhë në Kosovë me qëllimin e vetëm me taku familjen apo për me vazhdu aktivitetin tij?

Sami Shatri: Shiko, krejt ardhjet e Sali Shatrit kanë qenë për aktivitet. Se shpesh herë ai kur ka ardhë nuk ka mujt ta takoj fare familjen. Shpesh herë takimet janë bo krejt dikund tjetër. Për arsye se për shkaqe sigurie. Për shembull, përmendet n’atë shkrimin e Mehmet Muses ni takim që kanë pasë në Preshevë. Ni detyrë shumë sekrete bashkë me Shaban Brahën. Kanë shku në Preshevë, kanë pasë vendin ku takohen në ora dy t’natës që i kanë shpërnda detyrat edhe e kanë lanë në ora dy të natës të takohen.

Në ora dy t'natës është ardhë Shabani, po Saliu nuk ka mujtë t'vijë. N'atë, qysh e përshkrun Shaban Braha, n'atë kohë, domethonë kah ora dy nihen do krisma pushke dhe ai kujton që është vra. Dhe prit edhe pak, bile qysh e përshkrun ai, thotë, "Jom bo gati qysh ta formuloj ni tekst për Sali Shatrin për me nderu". Kah ora tre vjen, ai thotë që, nin diçka te dushku aty dhe e sheh që... përqafohen dhe thotë që i tregon arsyeën pse osht' vonu. Pra, ka pasë iks raste për arsye se ka qenë grupi ma i kërkun n'atë kohë, grupi ma i kërkun.

Unë kom shumë kujtime, kshtu që shoh, për shembull, kur kem shku në kufi, në kohën kur osht' shliku pak, janë përmirësu marrëdhëniet dhe kanë fillu të lëvizin njerëzit anej e knej. Gjyshja, jo, njerka e Saliut, jo nana se nana i ka vdekë herët, po njerka ka shku ta vizitoj. Se ai e ka dashtë shumë, e ka dashtë si nanën edhe ajo ka shku ta vizitoj. Kemi shku edhe na. Unë e mbaj mend si fmi i vogël viti '80 ka qenë ose '81 aty dikund. Jemi nisë aty dikund pesë vetura t'shkojmë në Vërmicë dhe ta shohim, bile ta shohim.

Kur kemi dalë në Klinë, na ka shoqëru ni veturë e policisë. Atëherë 101 zastavë i thojshin. Edhe na ka shoqëru deri në Vërmicë. Kur kemi mrrri në atë zonën, zonën ku duhej të qëndronim ne duhet të afroheshin edhe ata deri aty. Na u ofrum aty, mbaj mend ni erë fryke, ni erë shumë e fortë edhe erdh Saliu erdh me familje t'vet me ni xhip të ushtrisë. U duke larg dhe dul. Mirëpo ai nuk u ofru. Tash ne si fmi na ishim shku për me pa për asi edhe pak u asi... se nuk lanë ata, jo jugosllavët po ata nuk lanë. Tash na thojshim pse, qysh, si.

Ma vonë... e kem pa veç ni distancë diku 70 metra. E mbaj mend që dul ajo gjyshja edhe ai prej atjehit folke t'madhe me ni na për secilin. Ky osht' Sejdiu, ky është Emini, ky osht' ky, ky. Po nuk u ofru. Ma vonë aty kisha ni kufitar, nifar' Zija Gjonbalaj. Kufitari kryesor, doganier. Ma vonë n'konvikt unë isha me ni shok, nifar' Bashkim Hasangjekaj, cimer. Rasisht t'u bisedu ai e kish pasë daj, Zija Gjonbalën e kish pasë daj. Zija Gjonbala baba i Bukurie Gjonbalës dhe Afrim Gjonabalës që kanë qenë në Bruksel që u lajmrojshin si korrespondent.

T'u bisedu ksi soji... ata vishin shpesh. Afrimi edhe Bukuria vishin te Bashkimi në konvikt aty. Niherë erdh ai Zijai domethonë veç ai për me pa nipin e vet, Bashkimin. P'e shoh unë, i njeiti njeri që e kom pa atje. P'e pys, thom, ksi, ksi, "Na kemi qenë ni vizitë, a punon?" "Po", tha, "punoj", tha... po ia përshkruaj unë thashë, "Jemi ardhë po ata nuk u ofrun".

Po m'thotë tha, "E mor' Shatër, Sali Shatrin e ki axhë ti?" Thashë, "Po", tha, "A e din ti që sa herë del Sali Shatri nga Tirana na", tha, "tollovitem ktu". E kish fjalën për zonën kufitare. "Meniherë", tha, "bohet alarm, bohet", a din po qeshë, "Sa herë del", tha, "ai nga Tirana, lëvizë", tha, "na", tha, "ktu tollovitem", tha, "e mos u bon marak", tha, "shkaqe sigurie ka qenë", kshtu ma la. Mirëpo m'boni përshtypje që tha, "Saherë, saherë del ai jashtë Tirane na tollovitem". Domethonë m'boni përshtypje ajo që kanë pasë informata.

Anita Susuri: E axhi juj në Shqipni, në Tiranë çfarë roli ka pasë? Me çka u marrë pastaj?

Sami Shatri: Ai ka qenë, në bazë të shkrimeve që kom përcjellë ktu, ai Mehmet Musë Bala, në vitin 1950 ai e ka, e ka udhëheq sektorin e veçantë për Kosovën. E ka udhëheq. Ka qenë me grad kolonel n'atë kohë. Ka qenë i ri, vitin 1950 ai ka dashtë m'i pasë rreth 30 vjet. Ma vonë i kanë hjekë gradat, në Shqipëri nuk kanë pasë grada. Po me atë gradën kolonel ka qenë n'atë kohë. Kryesisht ka punu në operativë. Domethonë ai ka qenë kryesisht për punë në teren. Punë në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni edhe në Turqi.

E kom ni shkrim n'lidhje me ata, osht' shumë interesant. Ni fotografi e cila qarkullon prej Turqie dhe sigurimi prej Turqie e bjen në Istog dhe i thurret vllaun e Sali Shatrit dhe në bisedë informative ka qenë Sali Shatri në Turqi. Domethonë, detyrat e tij kanë qenë ashtu. Ai ka vdekë në vitin 1984. Ka vdekë në, në zonën kufitare nga infrakti n'zemër. Kjo është interesant lajmi kur na u ka komunikuar vdekja e tina. Ka qenë 4 nëndor, 1984.

Vllau i Naser Shatrit, Skenderi, ka ardhë dhe na ka thanë n'shpi që, "Përcillni lajmet se e kem pa mixhën Sali në televizion". Lajmet e para të orës 18:00 që i jepke RTSh-ja atëherë, i kishin pasë qit'. Kish qenë përvjetori i ni brigade dhe ai kish qenë me anëtarë tjerë të komiteti qendror dhe anëtarë tjerë aty. Mandena i kem përcjellë lajmet e orës tetë edhe orës 22:00, që i mbajshin ata dhe e kem pa. E kem pa. Domethonë ka qenë ni ditë para vdekjes. Ai faktikisht, na e kem pa me 4 nëndor e kanë qit' dhe telegrami ka ardhë me 5 nëndor që ka ndrru jetë.

Po kur ka ardhë ai telegram me t'thanë t'drejtën babai i tina nuk besojke. Thojke, "Jo more, osht' kjo informatë e UDB-së kom pasë edhe raste tjera. Nuk ka vdekë Saliu". Kemi ardhë në Prishtinë, e kanë lanë ni bisedë telefonike familja e tina. Halla Buqe domethonë gruja e Sali Shatrit me fmi dhe na kem qenë unë, ka qenë Dilja, çika axhës, Shabani vllau im edhe Nexhati, vllau i Haki Shatrit edhe Muhamet Shatrit. Kemi qenë aty për me folë n'telefon dhe me konstatu tamon qysh osht' puna.

Kem pasë thirrje në ora gjashtë, nuk ke mujt me marrë deri n'ora 20:00. Për arsye se asi soji ka qenë atëherë, lidhjet telefonike me Tiranë u konë shumë vështirë. Ka ora 20:00 kem marrë lidhje dhe kem marrë vesh nga gruja e tina që Sali Shatri ka ndrru jetë. Ka bo kërkesë mixha atëherë, Isai t'shkoj, s'e kanë leju. N'momentin kur osht' konstatu vdekja e tina kem hapë t'pane aty dhe meniherë ka ardhë kryetari i komitetit të Istogut, në atë kohë Krist Gegaj ka qenë dhe katër polic.

Unë isha aty te dera me prit njerëz kush vishin dhe e di që ka ardhë ai. Kom qenë aty. M'ka thanë, "Ti ma thurret Isen". E kom thirrë mixhën. Ata e kem pasë edhe arsimtar, ai ka qenë arsimtar i matematikës dhe i erdh keq. Tha, "Isa, unë kom ardhë", tha, "për ni punë", tha... mixha thotë, "S'ka problem, urdhno, çka po don?" Tha, "T'pane s'bon", "Pse", thotë, "s'bon t'pane", "Për arsye", thotë, "se Sali Shatri ka vdekë si armik i Jugosllavisë". Mixha i thotë, "Shiqo, ai ka qenë armik i Jugosllavisë po ai ka

qenë vllau jem që ma ka bo nana unë derën nuk e mbylli. Ti lej policët kush don me ardhë vjen”, “Jem kojshi”. Tha, “Mu po m’vjen keq po është urdhër prej nalti”.

Atëherë u kthyn ata, na kem majtë derën çelë. Njerëz kanë ardhë kryesisht natën, kryesisht natën për arsye se koha ka qenë që u përcillshin e ishin nëpër punë dhe është mbajtë e pamja. Mandej Isai është leju, tash, domethonë ai ka vdekë në nëndor të vitit 1984, ai është leju t’shkoj në pranverën e vitit 1985 te familja e Saliut. Po nuk ka pasë rast ta, ta përcjelli vorrimin, nuk ka pasë rast. Kjo ka qenë. Sali Shatri ka lanë katër fmi, domethonë sot janë, jetojnë në Tiranë. Ni vajzë e ka në Amerikë ndërsa tre tjerë janë në Tiranë. Punojnë, veprojnë, ksi soj është ajo.

Anita Susuri: Mundemi me vazhdu për kthimin e...

Sami Shatri: Po. Domethonë pas kthimit nga internimi kur vijnë në shtëpi, nuk gjojnë asgja n’shpi. Asgja domethanë. As prej bagëtie, as prej gjanave t’shkatërrune t’gjitha. Se serbin e kishin pasë hjekë kur janë ardhë këta. Shpija e pa fshime, pa... fillojnë jetën e re. Kujtojnë që do ta fillojnë atë jetë t’re, mirëpo vazhdojnë probleme tjera. Domethonë, meniherë mas internimit s’ka shku ni vit, burgoset prapë Isai edhe baba i Sali Shatrit në Burgun e Nishit edhe Goli Otokut.

Bile në ni dramë në Teatrin Popullor, nata e fundit e Goli Otokut quhet ajo, osht’ shfaq disa herë, përmenden aty. Domethonë burgosen jo vetëm këta por burgoset ni rreth i gjanë. Burgoset Osmon Shatri djali i mixhës të Sali Shatrit. Burgoset daja i Sali Shatrit Zekë Ibrahimaj. Burgosen dy vëllezërit e njerks së Sali Shatrit, domethonë Zelfijes, Nezir Blakaj dhe Osmon Blakaj. Burgosen disa nga Isniqi t’familjeve të Tahirsylve, e familje Bala disa. Domethonë, krejt aty ku ka pasë baza, ku ka nejt Sali Shatri, burgosen ata njerëz. Me vite, dikush ma pak e dikush ma shumë e tjera.

Anita Susuri: A kanë pasë kshtu gjygje ose...

Sami Shatri: Po, po. Kta kanë pasë gjygje, pos atyne që kanë qenë në Goli Otok. Në bazë të, se unë nuk e kom ditë, po n’bazë të ni libre që e shkrun Meriman Braha për Goli Otokun, shumica e t’burgosurve, domethonë, ai e përmendi ni shifër, rreth shtatë mijë e diçka... rreth tre mijë e diçka s’ka evidencë hiç për ta, faktikisht që kanë qenë n’burg. Ka edhe prej tyne që kanë lanë eshnat atje po nuk osht’ në evidencë fare.

Në Burgun e Nishit po. E di mirë vishin shoktë të burgut që kanë qenë bashkë. Ka qenë ni Mulla Ramë Govori. Bile dy rrugë e kanë emrin e tina, njona në Prishtinë tjetra në Podujevë. Ka qenë i dënun, ai ka qenë si NDSH⁵-ist. Ka qenë i dënun shumë vite. Ai vinte, u ka mbetë shoqni, vinte shpesh herë te na. Bile n’vit pa ardhë niherë nuk e lejke, në Tomoc.

⁵ Lëvizja Nationale Demokratike Shqiptare, e njohur me inicialet e saj si LNDSh ose NDSH, u bë një rezistencë thuajse totale antikomuniste në Kosovë ndërmjet viteve 1945 dhe 1947.

Ai tregojke, e tregojke vetëm ni rast për Isain që ka qenë me ta n'burg. "Ishim", tha, "n'burg dhe hupi", tha, "Isai edhe morëm vesh", tha, "që e kanë marrë", ata i kanë thanë vetmi, "në qeli. Nga informatat e burgut, nga gazeta, shtypi atje që ka shku", tha, "msum që në rrethin e Pejës ka ndodhë ni konflikt i armatosur në mes të grupit diverzant edhe ushtrisë jugosllave dhe kanë mbetë të vrarë disa persona. Atëherë n'lidhje me atë rast e kanë izolu Isain".

Domethonë për arsye se vllau i tyne ka kryesu atë grup dhe ka pasë ushtar të mbytur të Jugosllavisë. "E kanë lanë në vetmi rreth ni muj aty". E tregonin n'odë ata disa herë kur vijke ai. Vijke i nderumi Mulla Ramë Govori. Ni njeri shumë i fortë edhe tregonte. Ai ka qenë humorist, bonte hajgare shumë bonte. "Kur e lshun... se nuk e dishim", tha, "hiç çka u bo me Isain, a e kanë pushkatu a çka u bo. Kur e lshun", tha, "kish ardhë në 30 kilogram. Edhe ka ardhë", tha, "prej meje. M'shkun", tha, "lot". Ka qenë shumë i fortë, "E vështirë", tha, "kom kajt najherë. Po m'shkun vetëvetiu kur e pashë".

Ai që kanë bo hajgare mes veti i thotë, "Au Mulla Ramë po i lig koke bre". Tash ky i thotë, "O nuk po kaj", thotë, "që t'kanë bo kshtu po po kaj", thotë, "që t'kanë lanë gjallë" (qeshë) tha, "u përqaqum". Kanë pasë shumë, ka pasë shumë aso raste. Ka pasë tortura të jashtëzakonshme. Shembull tregojnë që në qelitë e burgjeve serbe edhe gjarpnin e kanë shti. Tregojnë që, tregojnë që, njeriu po u shoqnojke edhe me gjarpën. Për shembull mixha i ka kapë me dorë gjarpnajt. E di nuk e kish problem atë punë hiç, na u tutshim. Domethonë u msu. Ksi soji.

Mas internimit atje kanë fillu vujtje tjera. Baba i Saliut është lshu ma herët. Për arsye se ligji ka qenë asi soji që sa ma afër te kish personin, dënimi është ma i vogël. Për arsye se baba djalin e ndihmon se e ka djalë, e ka. Po varet edhe prej aktivitetit që kanë pasë. Mandej lshohen këta tjetër me radhë nga burgu. Shembull daja i Sali Shatrit i ka majtë tetë vjet burg, tetë vjet burg. Mandej këta të Isniqit kanë majtë shumë burg. Gjithë këta kanë qenë ku kanë qenë baza ku këta jonë strehu, jonë ushqy.

Shembull Emin Shatri, baba i Muhamet Shatrit edhe Haki Shatrit tregojke që saherë ka ardhë Saliu, nuk ka ardhë direkt në familjen e tina po ka ardhë... se ata i kanë pasë shpijat pak ma larg. Gruja e Emin Shatrit, e nderuara dada Xufë tregojke baci Emin, "Kurrë n'jetë", tha, se ai u ardhë natën, u ardhë në dy t'natës, në tre t'natës edhe i kanë pasë ato trokitjet e caktune. "Veç trokiste n'xhom", tha, "unë u çojsha edhe veç e preksha grujen ajo", tha, "e dijke, u çojke. Qysh bre osht vonë, qysh me ma nxjerrë gjumin? E ka ditë çka, u çu e ka përgatitën bukën osht' pshtjellë buka edhe ju ka çu. Ai ka shku, ky ka ditë ku me shku n'vendin e caktun, ju ka çu buka".

Domethonë gratë shqiptare janë të jashtëzakonshme. Ato osht' dashtë të mbahen në ni konspiracion tepër t'madh edhe u dashtë t'kesh ni vullnet t'fortë që... se ajo nuk ka ndodhë niherë. Ajo ka ndodhë shumë herë. Shpesh herë baca Emin tregojke që ka flejt veshun, në mënyrë që kur t'vijne sa ma shpejt me kanë i gatshëm me i ofru ato që ia kanë ofru. Këso peripetish kanë pasë, këso vujtjesh. Mas kryerjes së burgimit, domethonë mas kohës së internimit, domethonë ka qenë ni burgim përpara kohës së internimit, internimi mandej prap burgosja tjetër.

Pas këtij ka ra politika e Rankoviqit, u shliu pak situata, ka ardhë viti '74, vërtetë vitit '68. Janë bo përgatitjet për flamur. Grupet diverzante kanë pru flamuj nga Shqipëria, kanë shkepë flamuj. Ajo dihet në mënyrë ilegale. Për shembull, dihet kur, kur njeri i caktun, patriot i caktun në Kosovë e kanë, e kanë ngrit flamurin në tren. Ato s'e kanë pa hiç. Treni ka kalu për Beograd ka shku në Athinë. Ajo osht' ni vepër e madhe që kanë bo djemtë e Pejës. Tash nuk e di saktësisht kush po shkrun, ka shkrime. Ata flamuj kanë ardhë nga Shqipëria.

Kanë ardhë libra kanë ardhë. Ni punë e madhe osht' bo për shkollimin e femrës. N'atë kohë ka qenë shumë vështirë t'binden, sidomos pjesa e fshatarëve, që femrat t'shkojnë n'shköllë. Për shembull, unë e di bisedën që ka pasë Saliu me njerëz që ka pasë kontakt për punën e shkollimit të femrës. Ata kanë thanë, "Po Sali qysh po dalin femrat jashtë traditës tonë?" Edhe ai i ka bind kshtu, ka thanë, "Ju jeni n'luftë, sikur me qenë n'front. Në front krejt nuk shpëtojnë, dikush bjen. Po me rëndësi është fitorja", edhe ka thanë, "a ma mirë kur e çoni grun ose motrën te mjeku me kontrollu ni mjeke shqiptare apo serbi?"

Kadal dal kanë fillu si n'fshatin tonë, si n'fshatra përreth të shkojnë femra n'shköllë. Me vështirësi t'mëdha. Disa nuk kanë pranë, disa nuk i kanë çu hiç. Mirëpo ka shpërthy ajo, ka asi, edhe mas ni kohe, mas dhjetë vite veç u bo masovike. Ma ka qenë turp për dikond që nuk e lejon vajzën t'shkon n'shköllë. U bo ni punë e jashtëzakonshme. Mandej përgatitje për vitin '68. Përgatitja e demonstratave të vitit 1968. Formimi i grupeve ilegale që kanë punu në ilegalitet. Të gjitha janë dirigju, janë dirigju nga sektori i veçantë për Kosovën.

Spektori i veçantë për Kosovën që na s'e kem ditë, shembull ka punu edhe në mbledhjen e armëve. I nderuari, tash i ndjeri, Ramush Tahiri, ish këshilltari i presidentit Rugova, në ni intervistë që thotë, thotë, "Kur kemi qenë në Shqipëri, na ka prit Ramiz Alia dhe na ka dhanë çelsin e depove të armëve. Atë çelës e ka pasë veç ministri i mbrojtjes edhe ju kanë dhanë edhe i kanë çu", ai thojke që i kena vizitu, s'e di në Durrës m'doket, edhe "kur kem hi, ajo depo e pa hapne fare me armë", do të thotë, "këto janë të destinune për juve".

Qysh ai e thotë në ni intervistë në televizion që e kom dëgju. Ai shkon, Ibrahim Rugova kish qenë n'atë kohë në vizitë, në Gjermani kur shkon e takon Bujar Bukoshin dhe Rugovën dhe i thotë ksi, ksi, ksi osht' puna. Rugova i thotë, "Duhet të konsultohem niherë me Shtetet e Bashkune të Amerikës e mandej të marrim vendim", dhe ashtu u bo. Domethonë krejt ato kanë qenë punë të sektorit të veçantë. Punë e sektorit të veçantë ka qenë edhe afrimi, afrimi i të djathtës dhe të majtës, sa këta kanë pasë mundësi. Për shembull, takimi i Demali Pozharit. Demali Pozhari ka qenë krye ballisti, ka qenë në emigrim. U bo takimi i Demali Pozharit me Enver Hoxhën, direkt. Ajo u bo përmes kontakteve të grupeve diverzante.

Kadal kadal, duke punu mandej në hapjen e universitetit. Hapja e universitetit në Prishtinë, ardhja e profesorëve nga Tirana me dhanë msim, punë e jashtëzakonshme. Janë zgjedhë profesorët ma t'mirë.

Unë kom pasë rast me profesor t'mirë t'bisedoj. Për shembull kur ka ardhë Kristian Bukuroshi, kish qenë ni matematicient i njohur. Çfarë kulture ka pasë, çfarë niveli ka pasë, Rexhep Mejdani. Domethonë të gjithë ata kanë ardhë, kanë dhanë msim ktu dhe mandej kanë... librat e tyne që është bo nifar' pjesë e Kushtetutës e '74-tes ni demokratizim i brendshëm dhe gjithë ato kanë lujt rolin e vet.

Derisa ka ardhë '81-shi, viti '81, ne e dijmë. Sigurisht ju jeni t'reja nuk e mbani mend. Viti '81, tash mendimi jem është, i ka parapri shumë televizioni i Tiranës. Domethonë, Shqipnia ka investu shumë në transmetuesin e RTSh-së dhe në vitin 1979, '79-ten m'duket ka qenë, kur për herë t'parë e ka mbulu territorin e Kosovës televizioni shqiptar. Unë mbaj mend natën e parë të emisionit ka qenë 28 nëndori a ka qenë '79-shi a '78-shi nuk e di se nuk muj, edhe kish qenë duke vallëzu Ansambli Shtetnor i Kangëve dhe Valleve. Ata i përgatitshin mirë n'atë kohë. Rastësisht e asi dhe u shfaq televizioni shqiptar.

Prej asaj kohe ka ndrru situata. Sepse deri n'atë kohë për shembull ne që kemi qenë t'ri n'atë kohë jemi konë të frymëzun, të ndikun, jo të frymëzun. Se na frymëzimin e kem pasë nga familja po të ndikun se s'kem pasë tjetër çka me pa, televizionin serb të Beogradit. E mbaj mend si sot ato seriet e tyne "Pozorište u kući [srb.: Tetatër në shtëpi]" do far' filmash, "Valter brani Sarajevo [srb.: Valteri mbron Sarajevën]"

Kemi qenë të ndikun për arsye se edhe n'shkollë kur shkojsha ato u diskutojshin si i kishin pa kshtu. Televizioni shqiptar i pret ato si me shpat dhe mandej fillojnë Kosova në përgjithësi ta ndjekun, ta ndjekun televizionin shqiptar. T'i ndjekun dramet, filmat, artistat. Mandej nuk folke kërkush ma për Milena Draviqin ose Dragan Nikoliqin po folke për Tinka Kurtin, Sadhe Procin, Ndrekë Luca. Gjithë artistë shqiptarë që, që ishin. Kangtë, emisionet.

Ata kanë pasë, për shembull, t'premtën ka qenë ni emision ngjarje dhe data, gjithmonë e kanë pasë ata. Ata gjithmonë u konë ose për figurën e Isa Boletinit ose të Azem Bejtës ose Hasan Prishtinës. Njerëzit kanë mujt, kush ka dashtë, m'u ndiku. Kush s'ka dashtë... se unë kaniherë i shoh do në Shqipëri dalin do thojnë, "Na nuk kem ditë kurgjo për Kosovën". Po kur na kem marrë vesh përmes tyne, përmes atyne emisioneve po sigurisht ata s'e kanë kqyrë i ka interesu diçka ose televizion italian ose diçka tjetër. Ajo tani televizioni ka bo punën e vet. Ardhja e grupeve në koncerte me artist shumë t'zot e kanë bo punën e vet.

Anita Susuri: A ju ka ra juve me i pa kto për shembull shfaqjet që kanë ardhë? Ansamblet?

Sami Shatri: Po, po, po. I kem pa. Sa unë kom, sa mosha jem e ka mrri ata. Për arsye se mandej '81-sha i prishë marrëdhانيت dhe ndalohen ato. Kanë qenë tepër të pregaditne, tepër kanë qenë mikëpritëse mirëpo edhe masa ka qenë... e mbaj mend ni koncert në Prishtinë që nuk i kanë zanë, domethonë, numri i biletave ka qenë i kufizun. Aq njerëz ka pasë përjashtë që edhe pse nuk u ndëgjojke mirë atje po rrishin aty, rrishin aty. Aq ka qenë frymëzimi i madh. Mos t'flasim për, për atë kohë kanë fillu edhe

burgosjet. Dikush që ka shpreh naj parollë e ka përdorë ose diçka, “Rrnoftë Shqipëria”, ose, “Kosova është Shqipëri”, meniherë është burgosë. Meniherë ka qenë procedura në 60 ditë, kësi soji.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Periudha e viteve të ‘70-ta kur ju veç keni qenë fmi osht’ cilësu shpesh si ni periudhë pak ma e ndritshme se osht’ edhe Kushtetuta edhe hapja e universitetit. Qysh e kujtoni ju këtë periudhë? Si ka qenë në familjen e juv situata?

Sami Shatri: Po. Unë jom ‘64, në fund të ‘64, domethonë nëntor të ‘64-tes. Si fmi unë s’i kom përjetu ato burgosje, malltetime, internime. Por, i kom përjetu në ni formë tjetër. Domethonë, na gjithmonë si familje edhe n’shkollë edhe në atë kohë kemi qenë diqysh si të, të veçum, të veçum nga ai aspekt. Tash ka qenë disa, disa që kanë pasë pikëpamje si na, na kanë pa ndryshe, Disa që kanë pasë pikëpamje tjera na kanë pa ndryshe. Shembull, mu m’kujtohet vizita e Titos në vitin 1979, m’doket...

Anita Susuri: Po.

Sami Shatri: Që, që, që e ka ba në Kosovë.

Anita Susuri: Vizita e fundit m’duket ka qenë...

Sami Shatri: Po, po, po. Unë kom qenë i vogël, pak, a din, si nxanës e mbaj mend atë vizitë. Veç e di që u folke n’atë kohë që itenerari i lëvizjes së eskortës së Titës ka ndrru. Ku e di? Se atëherë ata përkrahësit e tina kan’ bo përgatitje që, ajo vetura e tij të vjen kah Peja e t’kalon në Gurakoc edhe kah rruga jonë që shkon kah Tomoci edhe t’shkoj në Istog. Mirëpo ajo pat’ ndrru kahje edhe kish shku kah Mitrovica edhe n’anën tjetër kishte dalë. Atëherë u folke që, që për shkak të grupeve diverzante. Për shkak grupit të Sali Shatrit ka ndrru. Për shkaqe sigurie.

E mbaj mend atë, atë insert që u folke. Si fmi kom qenë. Mandej, si fmi, unë nuk kom pasë këso raste tjera. Osht’ fjala te burgosjet, te malltretimet. Mirëpo si fmi e mbaj mend që lëvizjet e policisë rreth shpije. Shembull e mbaj mend ni rast bashkë me, me Dilen, çikën e axhës, ish herët, diku ora 06:00 e mëngjesit ose 05:00 e mëngjesit. Ne kishim t’shkonim n’shkollë edhe u çum me mbledhë arra. Kem pasë ni bahçe rreth tre hektar me pem të gjitha pemtë kanë qenë. Ajo bahçe ka qenë e rrethune me arra rreth e rreth. U çum të mbledhim arra se pat’ fry era natën edhe mandej t’shkojmë n’shkollë.

Kur folëm aty n’skej të bahçes kish pasë polici. E kem aty të kufizun me disa kusheri tokën edhe u dëgju gardhi që ata e kalun gardhin n’anën tjetër kur na pan’ neve. I pam uniformat. Shkum na mas asaj edhe po ju thojmë mixhës, e takum mixhën, i thojmë mixhës, “Mixh”, qishtu, qishtu, “ken’ do polic”. Ai

ndoshta mos me na frikësu tha, “Jo more ju ka dokë juve”. Na, nuk e boni atë far’ pune. Domethonë ata e mbaj mend në memorie që e kem përjetu bashkë me Dilen, me çikën e axhës.

Tjetër, shembull, në, si konviktor që kam qenë në Fakultetin e Elektroteknikës vitin e parë e kom marrë konviktin n’bazë të ni kusherini tem Naim Shatri i cili e kish shok ni Xhevat Kadria, ka qenë në Lidhje të Rinisë. Nuk m’patën bo problem. Vitin e dytë edhe pse e kisha fitu kushtin në qershor, vitin e dytë nuk ma dhanë konviktin. Nuk ma dhanë konviktin edhe nuk e disha arsyen. Shkova m’thanë që karakteristika ka ardhë prej Lidhjes Socialiste të fshatit dhe nuk munësh m’u vendos këtë vit.

Shkova aty, ka qenë ni shitore aty n’fshat. Ai kryetari i Lidhjes Socialiste po i thom... u mundu, dëgjoj arsyen n’fund u dashtë me m’thanë, “Osht’ ardhë urdhëri prej komitetit në Istog që nuk munësh me kanë n’konvikt”, “Për çka”, thashë, “unë, çfarë arsye?” N’fund tha, “E ki mixhën në Shqipni”, tekstualisht. Atëherë jom kthy, e disha që s’ka shpresa për atë punë. Me ndihmën e profesorit Hajdar Peci, që e falënderoj shumë, m’u ka dhanë ni mundësi me ni dyshek të vendosun në konvikt me studentë të Fakultetit të Bujqësisë, jo të elektroteknikës. Po me hupë pak gjurmë dhe me student e Fakultetit të Bujqësisë, aty jom vendos.

Mandej aty u liru ni krevet krejt dhe aty kam qenë i vendosur. Pra, konvikti ma kurrë s’mu ka nda. Gjithmonë kom qenë ashtu ilegal te dikush derisa e kom kry fakultetin. Pra, kjo e di si masë që unë e di pasojë e asaj t’kalunës t’familjes. I burgosun nuk kom qenë. Ushtar kom qenë. Kom pasë thirrjen, kam shku ushtar. Ato biseda informative po, sikur çdo ushtar tjetër që i ka pasë. Po unë kom qenë i ri ushtar, pa i bo 18 vjet.

Domethonë kom shku n’korrik të vitit 1982 në nëntor i kom bo 18 vjet. Domethonë jom konë shumë i ri. Për arsye se n’atë kohë, n’atë kohë ka pasë edhe shumë, veç ka pasë fillu malltretimi i ushtarëve në armatë. Shembull, kusherini jonë Haki Shatri, Haki Rexhep Shatri, osht’ kthy i vdekur, ditën e fundit e kanë vra. Ditën e fundit të shërbimit ushtarak kur gruja e ka prit n’shpi, baba, nana, vllaznia e tjerë ai ka ardhë në arkivol.

Anita Susuri: A ka qenë t’njejtën kohë si ju a po...

Sami Shatri: Jo, ai ka qenë ‘80 m’duket ‘85 ose ‘86 nuk e di, Hakiu. Po problemi ka qenë që ai ka qenë ma i vjetër, ma i pjekun. Kta që ishin ma t’vjetër, sidomos këta që ishin me fakultet edhe me nga familje që ata i konsideronin si familje armiq, i merrnin n’pytje i malltregonin shumë. Ai i ka pasë mbi 27 vjet kur u shku, se ka qenë i martun. Ka qenë stomatolog, teknik stomatolog në Istog. Djalë shumë i zoti, djalë shumë parimor. Po që fati i tina. Ditën e fundit ka ardhë në arkivol.

Anita Susuri: A ju kujtohet, nëse mundeni me na tregu rrethanat krejt qysh ka ndodhë kjo?

Sami Shatri: Po thjeshtë, ai ka pasë, qysh tash n'bazë asaj që kom dëgju nga familjarët e tina, ai ka pasë presione, biseda t'vazhdueshme informative. Ai ka qenë djali i Xhafer Shatrit, bash djali i axhës. Se Xhafer Shatri ka pasë bisedë të rana informative. Për arsye se familja e tina thotë që kur, kur u lajmëru me letra, me i ka cekë ato, ato. Ka ardhë momenti kur osht' vra.

Ai arkivoli e kanë pru deri në Pejë, s'e kanë pru deri aty n'fshat. Mandej kanë shku familjartë e kanë marrë. Sikur për krejt kanë thanë arsyen ose e ka vra vetën ose... arsye të ndryshme. Mirëpo arkivoli ka qenë i mbyllur, i bllokun. Sikur për krejt ushtartë tjerë. Nuk osht' vorros me nderime ushtarake. Ai tregon që është vorros domethonë si armik i shtetit. Kshtu ka qenë. Unë nuk e kom pasë atë fat, me t'thanë t'drejtën.

Unë kom fillu shërbimin ushtarak në Sombor, mandej kom qenë në Novi Sad nja 15 ditë, mandej në Rajlovac të Sarajevës. Në Sombor u kanë ai që i thojshin atëherë, ai, ata thojshin, me kry obukën, me kry atë pjesën e ushtrimeve të përgjithshme. E mandej jemi shku në Novi Sad. Në Novi Sad kemi qenë gjashtë shqiptarë që na kanë çu aty. Aty kish qenë ni bazë ushtarake nëntokësore, në Novi Sad edhe s'na kanë lanë me shku. Na kem nejtë aty nja, me t'thanë, dhetë ditë. Të gjithë, jo veç unë, të gjithë ata shqiptarë.

Na ka thirrë ni nëntoger hungarez, djali i ri n'zyre edhe na ka thanë tekstualisht, "Janë do rrethana qysh janë, ju si shqiptarë nuk muni, e kem pa të arsyeshme që..." ajo kish qenë bazë për aviacion, bazë nëntokësore. "Nuk muni ktu po vijnë gjashtë tjerë ju shkoni tjetër kund". Mbas nja dhetë dite i kanë pru gjashtë serbë të tjerë. Na jemi, tre jemi shku në Rajlovac të Sarajevës tre kanë shku në Mostar. Ata që kanë shku në Mostar kanë pasë fatin e keq, tret kanë ra n'burg.

Pra u kanë Avdush Canaj, bile shkrimtar për fëmi u kanë ni djalë jashtëzakonisht i mirë, i kulturum. Atina ia kishin pasë mbytë vllaun n'burg, shkrimtar ka qenë vëllau i tina. Ai ka pa ardhë me fakultet të gjuhës shqipe, i vjetër, domethonë rreth 28 vjet. Atina i bojshin presione. Ai ka qenë i smutë prej zemre diçka. Ata kanë ra tre n'burg. Po s'kanë ra veç tre, aty ka ra ni grup i 30 e kusur shqiptarë. Ka qenë, qysh i kom pytë mandej, masi janë lëshu prej burgu.

E kom pasë rastin të takoj Avdushin. Kanë qenë inskenun sikur rasti i Paraqinit. Që Aziz Kelmendi gjoja se ka vra ni slloven, e ni boshnjak e ni serb. Në mënyrë që m'i kompromitu shqiptartë, me ju thanë që jeni armiq të Jugosllavisë. Ata i kishin pasë akuzu që kanë bo komplot mrena diçka që kanë dashtë me helmu këtë ushqimin e kuzhinës, çka po di unë, qashtu diçka. Po kanë ra 30 e ca vet përnihërë. Kush ka qëllu në qaso kazermash me epror serb t'porositur për ato punë, ai ka psu. Ka psu. Plot ushtar ka pasë që janë kthy t'vdekur n'aso raste. Që faktikisht asni gja s'ka ba po ju ka inskenu diçka që kanë dashtë këta...

Anita Susuri: Sa i kanë mbajtë n'burg?

Sami Shatri: Oh, Avdushi m'duket i ka mbajttë pesë vjet. Feka i ka mbajttë katër vjet edhe nifar' Nexhat Imeri i Gilanit, s'e kom taku kurrë, ata nuk e di. Domethonë nuk e di. Po këta tre, bile po ju tregoj, kur e kom pa Avdush Canën te Biblioteka Popullore mas burgu krejt flokë t'bardha. Domethonë krejt, krejt, krejt. Se ka pasë shumë flokë, i ka pasë t'zeza si djalë i ri, krejt floktë e bardha. Mandej bisedum e m'tregoj qysh, qysh i kanë inskenu dëshmitarët e rrejshëm, fatkeqësisht shqiptarë, fatkeqësisht shqiptarë. Ashtu ka qenë koha.

Anita Susuri: Po m'intereson ju a ju kujtohen çfarë moshe keni kuptu për historinë e familjes ose keni fillu me lexu?

Sami Shatri: Po. Na gjithmonë jemi, kemi qenë të frymëzuar. Bile unë e di kur, kur vijke ndonjë letër në rrugë ilegale prej axhit Sali, na të gjithë mblidheshim aty edhe e komentim atë letër. E kem pasë edhe ni kasetë, ni kasetë që ka pasë ardhë po ajo kasetë ka humb. U kanë ni inxhizim me zanin e tina. Si sot m'duket ajo e mbaj mend se e lshojshim shpesh ato kur thonte, se ka pasë edhe humor, "Mos keni dert se as nuk do t'smurem, as nuk do t'vdes pa ardhë edhe niherë me ua tollovit atje edhe pa e bo Kosovën me Shqipërinë bashkë". Kjo ka qenë fjala e tina që m'kujtohet gjithmonë. Fati ka dashtë që ai t'shkon n'kohën kur osht' dashtë ndoshta ma së shumti. Po i ka lanë pasardhësit që kanë vazhdu atë rrugë dhe kem ardhë deri ku kem ardhë, deri sot.

Anita Susuri: Po du me ju pyttë edhe për '81-tën, paraprakisht ni familje që ka ndodhë...

Sami Shatri: Po, '81-ta, ngjarjet e '81-shit na kanë gjetë sikur t'gjithëve. Domethonë pjesëmarrës në ato ngjarje. Ni kusheri i joni, kusheri i afërt, vllau i Naser Shatrit, osht' nxan në atë kohë në grup të organizun dhe është dënu me 60 ditë burg. Edhe kusheri tjerë po osht' fjala ngjarja fillon te ai. Ai ka qenë i fejun në Vrellë të Istogut dhe mbas burgut osht' martu.

Dasma e tina osht' domethonë bashkësia familjare, baba e ka organizu dasmën, janë thirrë dasmorët. Në dasmën e tina jom konë edhe unë pjesëmarrës. Kemi shku, atëherë kanë qenë traktorat, vetura ka pasë pak, ka pasë nja dy-tre vetura dhe tjertë kanë qenë traktora kur kemi shku me marrë nusen. Jemi ndalë në qendër të Istogut, ish ai entuziasmi i ngjarve të '81-shit. N'qendër të Istogut krejt dasmorët dhe kemi këndu. Domethonë traktori i fundit ka qenë me t'ri, rreth 20 veta. Kemi këndu shumë.

N'atë ditë osht' këndu për herë t'parë kanga e Selman Kadrisë në ni distancë rreth 100 metra prej shpisë të Miliq Kërcës, prej trollit Miliq Kërcës. Osht' këndu me za shumë t'naltë. Krejt banortë e Istogut kanë dalë nëpër terasa edhe kanë ndëgju atë jehonë të asaj dasme. Ka zgjatë ajo rreth 40 minuta në qendër të Istogut dhe jemi nisë për Vrellë. Për Vrellë atje ku na kanë prit miqt, këngëtarët e kanë knu edhe atje ni kangë. E jemi kthy, qysh janë traditat në Tomoc.

Kah ora 09:00 e mramjes kanë rrethu policia shpijen e Naser Shatrit, Skender Shatrit domethonë shpinë e Sadik Shatrit, babës tyne. U prish dasma. Domethonë u prish dasma para se të hi dhandri.

Janë burgosë dy vllaznit e Naser Shatrit, domethonë Enver Shatri dhe Nysret Shatri t'cilët unë i kom pasë n'klasë. Ata kanë qenë t'ri n'shkollë t'mesme. Osh't' burgosë vllau i Sali Shatrit, Isa Shatri. Për herën e sa po i bjen, e katërt, ata janë burgosë.

Naser Shatri osht' përjashtu prej pune. Ka qenë me punë në Kroaci, në Lepogllavë si gardian burgu. Meniherë automatikisht është përjashtu prej pune. Vllaznit e Skenderit, Enveri dhe Nysreti nuk i kanë lanë ma të drejtë shkollimi dhe kanë shku në Slloveni. Nga aty kanë dalë në perëndim, sot janë në perëndim me familjet e tyne. E përmenda këtë ngjarje se aty fillon edhe mandej edhe ni, ni episod i ri mbi ngjarjet e familjes Shatri ku tash protagonist kryesor është Naser Shatri.

Pra, ai përjashtohet prej pune, fillon aktivitetin e tina. Del në Suedi fillon aktivitetin e tina bashkë me Xhafer Shatrin që ka qenë n'atë kohë në Gjenevë. Nga atje merr instruksione, vjen mrena në Kosovë. Kanë shpërnda qysh ai i ka disa emisione nëpër televizione. Kanë shpërnda afishe, trakte edhe në Beograd edhe në Zagreb edhe në Lublanë në të gjitha ato vende kanë bo përgatitjet për me përgatitë opinionin për luftë të armatosne.

Në momentin kur, në momentin kur kupton UDB-a që diçka po lëvizë në atë drejtim, osht' viti '89, është viti '89, n'atë vit domethonë në shtator të vitit '98 martohet vllau im Shabani edhe Naseri vjen nga Suedia. Se e kemi thirrë edhe n'dasmë. Vjen nga Suedia. Vjen me ni kamerë, si sot e mbaj mend, ni kamerë t'madhe. Atëherë u konë karakteristike edhe e inxhizon dasmën krejt aty. Ni javë mas, domethonë, me 24 shtator martohet vllau Shabani, ni javë masi i vdes nana Profesor Doktor Muhamet Shatrit. Kemi qenë në të pame. Në të pame edhe Haki Shatri aty.

Naseri ka shku n'bisedë informative në Istog. U kanë i thirrin dikun për tretën herë po m'duket. Ai ma mirë i sqaron ato në ato emisionet që janë. Ndodhë rasti, ndodhë rasti i vrasjes së plagosjes së randë të inspektorit Baboviq. Mandej osht' ajo historia tjetër e cila vazhdon. Pra, veç desha me lidh që edhe në këtë dasmën në vitin '82 kur martohet Skenderi, burgoset prap Isai, vllau i Sali Shatrit. Burgoset dhe dënohet me 40 ditë burg bashkë me dy vllazën të Naser Shatrit. Kjo osht' ajo çka unë mbaj mend prej... edhe mbaj mend krejt, krejt demonstratën e vitit '81 në Istog. Si ka fillu, kush e ka fillu, qysh ka shku puna...

Anita Susuri: Po, qata dashta me ju pytë, qysh...

Sami Shatri: E ata e mbaj mend mirë se diqysh m'ka mbetë edhe osht' e paharrueshme ajo, osht ni diçka e paharrueshme. Domethonë unë kom qenë në gjimnaz, bashkë me Dilen, çikën e axhës, kemi qenë edhe ni klasë edhe ni bankë edhe n'fakultet kemi qenë bashkë ashtu edhe ni shpi bashkë deri vonë. Kur kemi shku na atë ditë kemi shku n'kamë prej fshatit në shkollë. Pak me vonesë.

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: Ishit t'u na tregu për ngjarjet...

Sami Shatri: Po, për ngjarjet... na ishim, shkonim n'shkollë si vazhdimisht. U folke bile n'televizion ka qenë n'lajme që u lavdru Istogu që n'krejt Kosovë pat' demonstrata edhe Istogu strukturat politike, shoqnore, vetëqeverisje qysh kanë qenë atje kanë punu shumë edhe në Istog nuk ka pasë. Ka qenë m'duket 30 prilli, data. Kur shkum na afër shkollë p'e shohim ni turmë, ni turmë t'vogël me parulla, "Kosova Republikë".

M'ra n'sy meniherë e njëfsha dikond prej tyne aty. Na Istogu gati krejt, kryesisht, njerëzit të familjeve të njohura që kanë qenë. Për shembull, aty ni shok e kem pasë ni Avni Podrimën e pashë n'kry të demonstratës, ka qenë djali i Rexhep Podrimës. Ai familje shumë patriotike me t'burgosun. Nimon Podrima ka qenë i burgosun politik e tjerë. N'krye të kolonës ni vajzë me flokë bistek me gërsheta edhe me kapuç t'bardhë, me plis. Ajo i prike demonstratës. Hysnije Blakaj ka pasë emrin. Turma, turma mas sajna të familjeve Rexha, Sadikaj të Studenicë, Maxharraj e plot.

Mirëpo ajo turmë shkonte duke u rritë, duke u rritë vazhdimisht. Domethonë integroheshin njerëz nga anash, nga anash prej banesave dhe ka mrrri te shkolla. Na veç kem mrrri te shkolla. Kanë dalë mandej nxansat krejt, qashtu edhe unë jam bashkangjitur me turmën. Duke shku kah shkolla, domethonë duke kalu shkollën edhe m'u sillë rreth qarkut të Istogut ka ndërhy njësia speciale. Domethonë te fundi i oborrit t'shkollës ka ndërhy me gaz lotsjellës, me shkopinj gome edhe osht' shpërnda turma.

Janë mundu të rezistojnë sa kanë mujt po ka qenë e pamundur. Se gazi lotsjellës ka qenë tepër i shumtë. E mbaj mend aty osht', osht' rrah keq profesori Idriz Blakaj. Idriz Blakaj na jepke n'atë kohë matematikë. Ai është inxhinier i eletroteknikës po jepke matematikë. Ata se kam qenë shumë afër tina, ai osht' i gjatë mbi dy metra dhe tre polic e goditshin sa mujshin me shkopinj gome po nuk mujshin për me rrxu. Interesant u rezistoj atyne goditjeve, unë nuk e di qysh se sa mujshin e goditshin, me krejt forcën.

I kanë njëkë demonstruesit e tjerë nëpër ara, nëpër atje. Aty osht' plagosë ni vajzë n'ato ngjarje. Osht' shpërnda turma. Apet prap kanë tentu të bashkohen nga anë tjera të Istogut por prap ka ndërhy policia, kanë ardhë helikopterë kanë vëzhgu situatën rreth shkollës, rreth asi. Serbë e serbe krejt... se serbët kryesisht kanë qenë t'vendosur nëpër banesa në Istog, në terasa duke kqyrë, duke sha me ato sjelljet që i kanë ata. Ksi soji ka përfundu demonstrata në Istog e 30 prillit.

Mandej ka fillu fushata e burgosjes. U burgosë Idriz Blakaj me ni vit a ni vit e gjys burg. Janë burgosë edhe tjerë mësimdhënës që janë suspendu. Ka pasë edhe nxanës që janë burgosë, ka pasë demonstrues tjerë që janë burgosë. Kjo ka qenë. Faktikisht u hudh poshtë ajo e komitetit n'atë kohë që kanë punu shumë edhe Istogu hyni... e kanë mashtru në ato analet e historisë që me 30 prill ka demonstru me ni, me ni numër shumë t'madh t'rive, kryesisht të rinjëve në Istog. Pra ksi soji, unë çka e mbaj mend për

Istogun. Mandej duke u bazu në ato ngjarje janë burgosë njerëz të familjeve të ndryshme. Kryesisht familjeve që kanë qenë t'njohur.

Anita Susuri: E ju mandej qajo, ma vonë, burgosja n'atë dasmën...

Sami Shatri: Po, ajo '82-shin mas ngjarjeve, domethonë, Skenderi, vllau i Naserit ka qenë pjesëmarrës i ngjarjeve të '81-shit, ai u burgosë. E mandej kur, kur ka dalë prej burgu osht' martu dhe ka ndodhë ajo.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Ju tregut ma herët që në '82-ten keni qenë në ushtri edhe që shpesh ju kanë marrë në biseda informative...

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet çfarë pyetje kanë qenë? Çfarë biseda kanë qenë?

Sami Shatri: Kryesisht tash, se unë, e di edhe mu çka m'kanë pytë po edhe kolegët. Për shembull, e kem pasë aty ni shok, ni Bajram Uleta i Drenicës. Ai ka qenë me fakultet të gjuhës shqipe, 28 vjet i ka pasë. Ai ka hjekë shumë ma keq. Për arsye se ato e ngarkojshin thojshin çka bojnë këta t'rit ti i ki fajet, se ti po i shtin. Domethonë ia ngarkojshin edhe ato na që ishim ma t'ri. Mu kryesisht për familje, çka ki këta, "Çka e ki Xhafer Shatrin, çka e ki Sali Shatrin, a e ke pa najherë, a ke...", kryesisht këso, jo ma shumë diçka.

Fotografitë e mbaj mend që m'i patën çu do fotografi prej shpije se na dolëm, dolëm atë ditën kur shkova ushtar në fotografi. Po ato kur janë ndreqë te fotografisti m'i çun n'postë fotografitë. M'thirri n'zyre, e mbaj mend si sot, ai kapetani u kanë ni kapetan Jarkoviq. Shumë i poshtër ka qenë për shqiptarë. M'pytke tash n'bazë t'fotografisë për anëtarë t'familjes, kush osht' ky, kush osht' ky, për t'gjithë ata. A osht' n'shkollë, ku osht' n'shkollë. Qiso pytjesh.

Ai ka qenë i poshtër për arsye se vetëm shqiptartë, vetëm shqiptartë kur dilshim me bo atë hapin ushtarak në mëngjes, vetëm shqiptartë i pytke për ditar. "A ke përcjellë pram ditarin edhe shpjegona?" Tjertë jo, domethonë tjertë kërkush. Diqysh në mënyrë nënçmuese u shihke që osht', osht' shumë serbomadn. Në Novi Sad kem nejt pak, nuk kem pasë. Në Rajlovac na kem pasë fat në Rajlovac ka qenë komandant baze Anton Tus. Anton Tus ka qenë ni gjeneral, që ma vonë u bo gjeneral, që ka qenë i pari që pat' shku në Kroaci se ai ka qenë kroat. Bile u folke që ai osht' arbresh me prejardhje i Zarës. Edhe pat' shku n'luftë në Kroaci.

Na nuk e dishim, ma vonë tani morëm vesh. Po na shqiptarë në përgjithësi që jem kanë në Rajlovac, nuk na kanë asnjani nuk ka pasë ndonjë pasojë. Pse? Na bojshim do sherre, i bojshim do sherre na çojshin raport aty po raporti kryesor u kanë te ai. Domethonë me shku te ai. Ai e kthejke me ni masë t'vogël, shembull, tri herë me fshi tualetin jashtë radhës ose qiso masa t'vogla. Por jo në burgosje qysh ka ndodhë në kazerma tjera m'i lanë në vetmi me shumë ditë.

Ni insert që harrova, kur kam qenë në Sombor mu s'më kanë dhanë armë hiç, domethonë. Ushtartë tjerë dilshin me armë krejt, unë mas tyne qashtu shkojsha. E kom pasë si shok nifar Hasan Osmanaj edhe ai i Istogut që kom shku me to. Kur e fshijke ai pushkën, i nimojsha. Me arsyetim thojshin që, "Nuk kemi, sa t'na vijjnë". Qysh s'ka pasë Jugosllavia pushkë, ato janë konë do pushkë t'vjetra, do M48 i thojshin. Nuk kom pasë pushkë fare. Në Rajlovac po, m'kanë ngarku me pushkë po atje jo.

Anita Susuri: E n'kohën kur keni qenë ju në ushtri, a keni pasë informatë që grupin tjetër në Mostar e kanë burgosë?

Sami Shatri: Kështu ka qenë situata. Se ne jemi kanë në gjinin e lidhjeve, telepromptarista i thojshin. Aty ku punojshin kishim kontakte me telefona. Deri n'momentin kur janë burgosë ata, kem pasë kontakte me ta. Kem pasë kontakte me telefon kshtu se janë kanë shokë t'mirë. N'momentin kur ishin burgosë ata, na kem tentu sikur çdo herë m'i marrë. Zakonisht kur ishim në ndrrimin e natës aty folshim gati tonë natën aty. Nuk kemi mujtë, s'kemi mujtë. Nuk e kem ditë na arsyen për çka. Ma vonë ni shok i tyne që na s'e kem njoftë, që ka qenë i pa burgosun, osht' lajmëru edhe ka thanë, "Mos thirrni ma, mos i thirrni ma". Na e kem kuptu që diçka ka ndodhë po nuk e kem ditë çka.

Mandej ka qenë në shtyp që atje osht' burgosë, domethonë, në shtypin e ushtrisë që ka qenë ai shtyp periodik, gazetë e ushtrisë. Që atje osht' burgosë ni grup i madh në Mostar. Gjoja se kanë dashtë me bo komplot e me helmu ushtrinë e do qishtu, do gjana shumë, shumë palidhje. Jo me emra, nuk i kishin pasë qit' emrat po si ngjarje, si ngjarje. Na e kuptum. Po nuk e dishim sa i dënun, kush, sa, qysh, si. Tek masi e kanë kry ushtrinë e kom taku Avdush Canën edhe m'ka tregu për ato edhe çka kanë hjekë edhe çka kanë vujtë edhe që s'ju kanë falë asni ditë. Kto dënimet ushtarake shumë zor janë, janë amnistu. Bile kur kanë bo ankesë për aministim ua kanë shtu dënimin. Kshtu.

Anita Susuri: Sa ju ka ra me qëndru, ni vit?

Sami Shatri: Unë kom qenë me atë grupin 12 plus tre i thojshin. Ata që e çojshin ni vërtetim që është i regjistrun në fakultet i majshin 12 muj plus tre m'i kry masi te kryn fakultetin, ashtu ka qenë. Kshtu që unë m'ka ra me nejt dikund dhjetë muj e 20 ditë. Për arsye se atë pushimin që kom pasë, s'e kom shfrytëzu hiç. Kom qenë vetëm katër ditë n'shpi m'i pa t'mit.

N'kohën kur dojsha me marrë, n'fund dojsha me marrë pushimin erdh nifar' shkurtimi, ata i thojshin skraçeni. Erdh nifar' shkurtimi për atë gjeneratë. Ua falën dikund 20 ditë, në përgjithësi, jo veç mu po

kush u shku n'qat' far' date edhe i kom majtë dhjetë muj e 20 ditë. Jom lshu me 30 qershor të vitit 1983. A kom shku në korrik, me 16 korrik në vitin 1982.

Anita Susuri: Pas ushtrisë, sigurisht keni vazhdu fakultetin...

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: Si kanë qenë qato vite në Prishtinë? Si keni kalu kohën?

Sami Shatri: Vitet e studimeve, sidomos jeta konviktore është jeta ma e mirë që, që muret me përjetu njeri. Për arsye se n'konvikt zen shok edhe shoqe sigurisht të krejt anëve të Kosovës. Jo vetëm të Kosovës aty ka pasë të Preshevës, ka pasë të Malit të Zi. Jeta konviktore, organizimi i jetës konviktore osht' ni, ni, ni specifikë e veçantë. Domethonë, nuk e ki ma me ta përgatitë ushqimin nana atje ose dikush tjetër. Na kem pasë mensën që shkojshim n'mensë po mëngjesin u dashke me bo vet.

Domethonë në konvikt për herë t'parë për disa, se disa e mbajnë atë rend edhe n'shpi. Për herë t'parë qysh jom kanë unë është me majtë atë rendin shtëpiak. Me qit' çaj kur e ki radhën, me maru çajin shokve me ju qit' çaj, me ndreq krevetin. Që për shembull ato t'i ka përgatitë dikush n'shpi, po aty u dashtë tash vet. Pos asaj, u kanë jetë shumë e mirë se kur msojshim, msojshim bashkë, kur dilshim, dilshim bashkë, kur bojshim hajgare, bojshim bashkë. Të gjithë ishim nifar' jete shumë e mirë që ajo jetë edhe mas, mrapa studimeve...

Në përgjithësi jeta studentore është e mirë mirëpo edhe fati jonë si gjeneratë edhe aty fillojnë problemet. Domethonë fillon problemet e ngjarjeve të vitit '89. Unë kom qenë n'përfundim të studimeve atëherë por viti i fundit i studimeve ku i kemi përjetu ato. I mbaj mend mirë. Domethonë grevën e minatorëve. Ka qenë fjala për ndrrimet kushtetuese. Ndrrimet kushtetuese të mundshme të cilat Serbia i imponoi me forcën, me forcën e armëve edhe tankeve.

Unë e mbaj mend që është interesant me përmend dy momente të cilat janë ma merr menja interesant të mbesin të treguara, që janë edhe të shkruara. Se unë i kom shkru këto. Pra, momenti kur ka ardhë delegacioni i Serbisë në Fakultetin Elektroteknik për t'i bind studentat n'lidhje me ndryshimet kushtetuese. Që Kosova nuk humb asgja, që është avansim i autonomisë së Kosovës. Ka qenë nifar' neni 47 që ka qenë ai. Ai ka qenë problematik. Për arsye se me atë nen, me atë nen Serbia e ka marrë, e ka suprimu faktikisht autoritetin e autonomisë të Kosovës dhe e ka marrë primatin mbi Kosovën.

Tubimi është mbajtë në Fakultetin Elektroteknik. Aty kem qenë me thanë me qindra student. Se ka pasë edhe n'kamë njerëz edhe ulun. U bo ni diskutim. Kanë ardhë prej Kuvendit të Serbisë, nuk e di tash çfarë funksionesh kanë pasë po njani prej tyne ka qenë funksion t'naltë ka pasë në Kuvendin e Serbisë. Ka qenë edhe ni femër aty dhe kuptohet edhe këta tonët atëherë që kanë qenë në struktura udhëheqëse të fakultetit. Ai tubim osht' mbajtë në Fakultetin Elektroteknik në amfiteatër.

Në momentin kur osht' hapë mbledhja kanë reagu ni numër i caktun i profesorëve të universitetit atëherë të Prishtinës. Ma i zëshmi, ma i zëshmi prej tyne ka qenë profesor doktor Gazmend Pula. Kanë qenë edhe tjerët që nuk duhet me, me, ndoshta muj me harru ndonjë se kjo i ka 30 e ca vjet po ka qenë Selem Lepaja, ka qenë Avni Dika, profesori Avni Dika. Ka qenë, tash, ni Ahmet, nuk m'kujtohet se ai kish shku në Amerikë, nuk m'kujtohet. Asistent që kem pasë shumë t'mirë. Por fatkeqësisht, fatkeqësisht ka pasë edhe profesor të cilët i kanë arsyetu ato, i kanë arsyetu ato.

Unë mbaj mend Gazmend Pula s'i ka lanë me folë hiç. Absolutisht. Kur e kanë hapë mbledhjen për ndryshme ai ka dalë n'amfiteatër dhe u ka thanë që ju, "Këto janë demagogji. Ju keni ardhë për me shkatërru autonominë e Universitetit të Kosovës", dhe me ni fjalë n'fund u ka thanë që, "Kosova, Kosova i ka strukturat e veta, vendos vet dhe ajo vendosi mos me kanë me Serbi hiç". Pra, që ka qenë guxim i madh n'atë kohë, çka unë e vlerësoj atë far' pune.

Por, kanë qenë edhe profesor tjerë. Profesorët tjerë, është interesant, që gjatë msimit, pra, gjatë studimeve ata kanë qenë t'zorshëm nga aspekti patriotik kështu. Për Gazmendin nuk kemi pasë disi, nuk ka hy n'ato tema. Mirëpo kur ke, kur erdh momenti, momenti i duhur ai tregoj që vërtetë, vërtetë osht' profesor me ide patrotike, me ide çfare duhet për me qenë, çfare duhet për me qenë. Ajo mbledhje u prish mandej dulën n'koridor, jo p'e mbajmë dikund tjetër, jo s'pe mbajmë. Po u prish meniherë kem pasë msim me profesor Gazmendin dhe ka thanë, "Msimi nuk mbahet".

Osht' bojkotu Mensa e Studentëve s'pari nga katedra e elektroteknikës mandej me fakultete tjera kanë bojkotu. Jo krejt, duhet thanë, jo krejt, ashtu ka qenë koha. Por, pjesa dërrmuese. E mandej osht' kanë fillu masat e dhunshme, kanë fillu që rreth konvikteve të sillet policia, të sillet njësia speciale. Ka pasë ndërhyrje të njësisë speciale, ka pasë ndërhyrje në konvikt mrena. Shembull, në konviktin ku kem qenë na, autoblanda ka gjujtë ni gaz lotsjellës, ka hy nga dritarja m'duket 307 ka qenë dhoma edhe ka ra në ata kreveta aty. Aty ka qenë ni qebe edhe u kallë. U kallë ai kat, kati ku kem qenë na, bash ka ra.

Na kemi qenë n'këtë pjesën ma përpara, kem mujtë t'dalim lehtë mirëpo ata që kanë qenë n'pjesën e mrpame korridorit osht' mbush tim, ka pasë problem për me dalë, kanë hekë keq shumë për me dalë. Bile e kem pasë ni koleg, ai, nifar' Dedë Krasniqi, ka pasë problem me ni dorë. Domethonë e ka pasë pa këta, si me thanë, të paralizun atë pjesë se ni pjesë kanë dalë me çarçafa prej katit kanë dalë poshtë. Ai menzi, shoktë s'e kanë lanë vet, shoktë e kanë tërhjekë edhe kanë dalë t'gjithë. Kjo osht' ngjarje që m'rrin n'mend tana herët.

Kanë ardhë ngjarjet e, e minatorëve. Kur osht' kërku dorëheqja e Rrahmon Morinës edhe atij grupit që ka qenë në udhëheqje dhe janë mbyllë minatortë në Trepçë. Na si studenta jena mbyllë në sallën "25 Maji" atëherë i kanë thanë, jemi mbyllë aty. Aty, atëherë ka qenë ni organizim i jashtëzakonshëm. Ka ardhë ushqim edhe prej Peje, ka ardhë ushqim prej Gilani, prej Presheve. Se studentat aty kanë qenë

rreth tre mijë ose pesë mijë veta që kem nejtë. Derisa kanë dalë minatorët në mënyrë me u solidarizu me ata.

E di n'atë kohë që ndër profesorët e parë që ka ardhë n'vizitë të studentëve ka qenë profesor Gazmend Pula me grun e vet. Se ata e mbaj mend. Kanë qenë, mandej kanë ardhë të tjerët, të gjithë të tjerët. Ka ardhë Rexhep Qosja, m'kujtohet si sot. Se ai osht' figurë ma e dallushme kështu. Kanë qenë gati t'gjithë por jo t'gjithë, të gjithë por jo të gjithë, fatkeqësisht jo t'gjithë. Tani qysh e dijmë me ni mashtrim i kanë nxjerrë minatorët që e kanë shkru ni letër që gjoja kanë dhanë dorëheqje. Kur kanë dalë ata, faktikisht ka qenë veç lojë, po janë nxjerrë minatorët. Atëherë kemi dalë edhe na nga salla "25 Maji".

Kësi soji tani kanë vazhdu ngjarjet me ardhjen e Millosheviqit në Fushë Kosovë. Niherë në Fushë Kosovë ku ka qenë edhe Azem Vllasi që ka qenë atëherë kryetar i Komitetit Krahinor dhe burgosja e Azem Vllasit. Qëndrimi i mirë dinjitoz mu m'duket i Kaqusha Jasharit n'atë kohë n'lidhje me situatën që është kriju. Dhe suprimimi i autonomisë, mbajtja e ni kuvendi të dhunshëm që e votojnë, fatkeqësisht e votojnë. Se edhe aty janë nja shtatë a tetë që s'kanë votu. Pra, megjithatë presion, megjithatë s'kanë votu.

M'kujtohet m'duket Melihate Tërmkollli ka qenë njëra nga ato që nuk e ka votu suprimimin e autonomisë të Kosovës. Që për mu ka rëndësi shumë t'madhe që në atë presion t'madh kur për 100 e ca veta votojnë ti me dalë kundër, është dashtë guxim i madh. Por, nuk ka qenë e vetmja, m'duket nja shtatë a tetë kanë qenë kundër. Tjertë fatkeqësisht e kanë votu. Osht' ajo, a e ka kry Serbia? Prap e ka kry në mënyra të ndryshme. Por ajo e ka kry në atë formë që ka thanë, "Vet e kanë votu". Mandej e kanë... i dim masat që kanë ardhë që kanë pru deri te situata e luftës.

Anita Susuri: Po du m'u kthy edhe te salla "1 Tetori", "25 Maji" që thatë...

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohen fjalimet çfare kanë qenë? A ka pasë fjalime? Po mendoj ka pasë po çka?

Sami Shatri: Po ka pasë mjaft fjalime. Secili profesor gati që osht' ardhë i ka përshëndet studentët në mënyrën e vet, secili. Ka qenë, kanë qenë mikrofonat aty dhe kanë folë secili. Ajo ka qenë ni frymëzim, ka qenë për studenta që jem bashkë, mos keni dert, ku jeni ju jem edhe na, kem t'drejtë, qiso gjanash ka pasë. Po ka qenë ni frymëzim i madh. Unë e di kur ni profesor na jepke përkrahje ajo ish ni stimul i jashtëzakonshëm për t'gjithë ata.

Mos harroni, aty ka pasë njeri që ka flejt në sallën "25 Maji", n'ato far' karrikat. Sa u kanë, sa ka zgjatë ajo, se ka pasë njerëz që kanë ardhë prej viseve tjera edhe nuk kanë mujtë ma m'u strehu dikund, aty kanë nejt. Aq ka qenë ai frymëzimi i madh patriotik. Po ato punë mandej u rregullun në mënyrë të

dhunshme edhe pasoj Kuvendi i Jugosllavisë për prishjen e federatës ku dul, u ndan Sllovenia, Kroacia përfaqësuesit e tyre e Ishun takimin. Fatkeqësisht përfaqësuesit tonë mbetën aty dhe ndodhi çka ndodhi.

Anita Susuri: Ju thatë që n'vitin '90 keni diplomu...

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj për juve kjo periudhë?

Sami Shatri: Po, unë n'kohën kur kom diplomu meniherë jom punësu. Jom punësu në Shkollën Elektroteknike "Gjin Gazulli" në Prishtinë. Atëherë ka qenë Shkolla "Milladin Popoviq", qishtu e ka pasë emrin, shkollë teknike. Ku osht' kryesisht shkollë elektroteknike, me drejtime të elektroteknikës. Kom pasë rast që vetëm ni pagë ta marrë, ni pagë ta marrë, pagë e ish federatës jugosllave që ka qenë atëherë. Se pagat janë nda prej fondit të federatës. Ni pagë, pagën e parë.

Se unë jom pranë në tetor të vitit 1990 meniherë në dhjetor i kanë nalë pagesat. Pagën e parë kur fillojshe me punu nuk ta jepshin, ta jepshin n'fund t'vitit, qashtu u kanë si rregull. Kshtuqë e kom marrë veç pagën e tetorit, nëntorit m'doket. Kur ka ardhë dhjetori osht' nalë financimi me pretekstin që s'i keni pranë planprogramet e Serbisë. Edhe aty osht' ni ngjarje interesant që e dijnë krejt mësimdhënësit që kem punu, kolektivi.

Viti i ri '90-'91. U ndalu financimi për shqiptarë na nuk morëm paga. Serbët, se ka pasë, kolektivi u kanë i përzim, bukur shumë ka pasë serb e ka pasë boshnjak e ka pasë edhe turq aty. Ata kishin ble dhurata për vit t'ri, dhurata shumë t'mdha. Për arsye se ata i morën kah tre mijë marka dikund i bijke. Se mjetet që kem pasë na m'i marrë atyre ua kanë shpërnda për çdo shkollë ua kanë shpërnda. I qitën në tavolinë se na mandej filloj ajo salla e arsimtarëve të ndahet. Ata ishin në njanën anë, na ishim në anën tjetër. I qitën aty maje tavoline.

Ka qenë ni profesor, ni Xhevat Ahmeti, mandej kish shku, profesor i matematikës, kish shku në Amerikë, pat' migru. Ai bojke, bojke hajgare me ni serb aty edhe përpara bojshin hajgare qishtu se lujshtin kaniherë edhe shah. Po i thotë, "Qysh bre s'po ju vjen marre, nuk po ju vjen marre m'i pru bile çka i keni pru ktu?" Ai serbi po i thotë, "Xhevat", po thotë, "shumë lehtë e keni. Pranoni planet e Serbisë krejt po ua dhojmë. Tana po ua dhojmë". E mbaj mend atë shakaje të hidhur.

Fatkeqësisht tre profesorë janë kanë n'anën e tyre. Unë e kom cekë në ni shkrim edhe me emra. S'kom mujt m'i kursy për arsye se sjellja e tyre u kanë tepër e keqe, tepër e keqe. Domethanë, masat e dhunshme në shkollën elektroteknike duhet ta dijnë gjithë që e kanë pranë Arife Ukaj, motra e, motra e Halit Tërnovcit që ka qenë në paramendjen e Serbisë. Burri i saj, Shaqir Uka, edhe ka qenë ni Shyqri Luca, profesor i fiskulturës. Tjertë jo, tjertë jemi konë në taborin knej, ata kanë qenë me ta. Qishtu.

Ata ishin t'bindur që, që, ata e kanë mirë, që ata po mundohen për t'mirën tonë, që na s'kem t'drejtë. Bile atëherë u kanë ashtu shprehje e tyne që, ju me atë shtetin e Ibrahim Rugovës, juve po ju financojnë prej jashti, qiso gjanash. Mirëpo kryesorja ata kanë qenë n'bllokun tjetër edhe kanë nejt vazhdimisht, ajo është e keqja. Edhe derisa jemi nda prej që na kanë hjekë prej objekteve krejt, problemi është që kanë bo t'kqija. Kanë informu, kanë informu për takime, për gjana tjera.

Nxansat për shembull që u kanë problemi që ata edhe mbetën anej po msim u japshin nxansave tonë. Nuk kish ligj, na ende s'i kishim ligjet për m'i suspendu. Ajo jepke gjeografi, ajo gruja, ai jepke fizikë burri i saj edhe ky jepke edukatë fizike. Kishin problem nxansat. U thojke, sidomos kjo, Arife Uka, u thojke që ata po ju mashtrojnë, nxansat ia bojkotojshin msimin. Ajo tani vijke në sallë të arsimtarëve e bojke problem, "Ju po i shtini", qiso problemesh ka pasë. Derisa na kanë qit' prej objekteve shkollore.

Kur na kanë qit' prej shkollës atje, kemi shku me hy n'shkollë, ka ndërhy policia. Osht' lexu aty ni letër që mos tentoni me hy n'shkollë se përdorim masa. Atëherë jemi kthy dhe kem organizu msimin niherë në objekte private që kanë lshu njerëz e mandej në Velani e ka liru objektin, krejt objektin ni Fadil Govori. Fadil Govori ka qenë biznismen. E ka dhanë atë objekt për shkollë. Ai objekt ka qenë vetëm me fasadë të jashtme po mrena ka qenë i pa meremetun.

Në organizim me shkollën, drejtori i shkollës, ka qenë Jonuz Salih qe ma vonë ka qenë ministër i kimisë, ministër i drejtësisë, m'falni se kimist ka qenë. Me, në bashkëpunim me prindërit edhe me profesor kem organizu dhe u bo meremetimi i shkollës. Fatin kem pasë që kem pasë ni profesor shumë t'mirë t'përkushtun dhe që i ka njoftë gati të gjitha profesionet, zanatet. Se jeta e tina ka qenë qasi soji. Ai ka qenë dhandër i jem, burri motrës, inxhinier i elektroteknikës po që dijke me instalu edhe rrymë, edhe ujë edhe nxemje të gjitha kto puntë e ndërtimtarisë.

Kemi ble drrasa edhe i ka maru bankat. Isuf Dreshaj, profesor i elektroteknikës atëherë nga Vrella e Istogut që mandej vdes në moshën 43 vjeçare nga kanceri. I ka ndërto 100 banka, me dorë t'vet. I kanë ndihmu nxansat. Ai e ka pasë marrë atë aparatit që salldon, drrasat e reja, ato konstruksionet ia bojke me atë aparatit edhe e kem aftësu atë objekt. E ka bo instalimin e nxemjes qendrore, instalimi i rrymës ka qenë, domethonë, veç siguresa ato orën e ka instalu. Kem fillu. Kem fillu në atë objekt.

Për ni kohë t'shkurtë ka qenë në shkollat ma të dallume. Osht' fjala edhe në mjete të informimit e sene u organizu mirë. Kem pasë bo ni kabinet t'vogël. Bash ai Isufi, Isuf Dreshaj kish shku n'vizitë te motra e tij në Suedi për ni vizitë kshtu dhe atje në konsultim. Se ai ka qenë qasi tipi që n'vizita kur ka shku ka kqyrë veç i ka interesu për këtu diçka edhe ka shku me dhandërr t'vet me ni shkollë me pa. T'u bisedu ka thanë, kësi, kësi e kem punën atje. Ai ka thanë, "Kto ua dhojmë na krejt. Veç qysh m'i pru".

Kanë bo organizimin prej Suedie kanë ardhë ato aparatura t'cilat i kemë vendosë në katin e epërm të shkollës, në katin e tretë atje me ni kabinet t'vogël. U bojke ni punë modeste me nxansa. Aty kem kalu

prej vitit kur kom fillu unë n'vitin '90-të domethonë deri në vitin '99, kur ka fillu lufta. E mas luftës jemi kthy n'shkollë. Që unë kom punu edhe si bashkëpunëtor i jashtëm deri në vitin 2002. Domethonë masi ka përfundu lufta jemi kthy dhe kemi vazhdu msimin në shkollë derisa jom punësu tani në Koorporatën Energjetike të Kosovës.

Anita Susuri: Deri n'cilin vit keni punu si mësimdhënës?

Sami Shatri: Deri në vitin 2002. Domethonë para lufte deri '99-ten tani ni pauzë, tani '99-ten jom pranu në KEK po si bashkëpunëtor i jashtëm i majsha do orë se atëherë kish problem edhe me kuadër, meniherë mas luftës. Deri në vitin 2002. Në 2002 tani e kom lanë shkollën kom vazhdu vetëm atje. Kem organizu edhe msimin kur na kanë përndjekë që kem kalu në Maqedoni, kem organizu msimin në Tetovë. Unë kom qenë në ni komunë të Tenovës, Tenovë i thojshin.

Me disa arsimtarë tjerë të cilët i kem identifiku që janë asajde kem organizu mësimin. Na kanë lëshu ata dy klasë të lira në shkollën që kishin aty. Kem marrë evidencën e nxansave përreth që janë t'vendosur aty dhe derisa jemi kthy, domethonë, që ka përfundu lufta e kem majtë mësimin prej klasës t'pestë deri tetën. Me qat' kuadër që kem pasë. Jo veç aty, e n'komuna tjera janë konë struktura tjera, arsimtarë tjerë që kanë punu.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe n'kohën, n'atë kohën kur keni punu në Prishtinë, ku keni banu? Në cilën lagje?

Sami Shatri: N'kohën kur kom punu në shkollë e ki fjalën?

Anita Susuri: Po, kur jeni largu para luftës.

Sami Shatri: Ni kohë kom, osht' fjala, kur jom punësu në '90-ten kom nejt te motra, te dhandrri. Se edhe motra m'ka punu n'shkollë edhe dhandrri. Kom nejt te motra. E mandej, ma vonë '95-ten unë jom martu e kom shitë ni parcellë tokë atje dhe kom ble ni banesë këtu te fontana e kom pasë banesën te fontana. Aty kom banu.

Anita Susuri: E me bashkëshorten si jeni njoftu? A keni qenë shokë apo?

Sami Shatri: (Qeshë) Eh po. Jo. Kësi soji ka qenë, vllaun e nuses, vllaun e bashkëshortes unë e kom pasë nxanës, nxanës temin. N'kohën kur e bojshim meremetimin e shkollës u dashke m'u taku me prindt dhe me kërku ndihmë prej tyne secili n'bazë t'profesionit të tina çka munet me ndihmu. Ai baba i nuses, baballaku, ka qenë i punësun atëherë në Kosovën A edhe në lidhje me, ka qenë në këshillin e

prindërve për organizimin e punëve rreth shkollës. M'ka ra dy-tri herë të jem mysafir te ai aty. Aty jemi pa me nusen, mandej kem vazhdu takimet e tjerat e martesë e qishtu.

Anita Susuri: N'kohën kur ka fillu lufta a keni pasë fmi?

Sami Shatri: Po.

Anita Susuri: I keni pasë t'vegjël sigurisht.

Sami Shatri: Ni djalë e kom pasë, se unë dy fmi i kom, dy fmi i kom. Djali Arditi ka qenë dy vjeç, dy ose tri vjeç n'atë kohë. E mbaj mend mirë atë situatë. Na deri vonë kemi mbajtur mësim, mbledhjet që u majshim në shkollë, kërkoshim arsimtar të dijmë çka t'bojmë. Pra, ish fjala a të mbahet mësimi, a të ndërprehet mësimi, a t'shkojmë krejt n'luftë, çka ish. Përgjigja atëherë e Lidhjes Demokratike të Kosovës e cila ka udhëhequr n'atë kohë thojke që ju t'rrini. Bile ka qenë ajo parulla me mbrojtje pragun e shpisë, qashtu ka qenë.

N'kohën kur fillun luftimet, veç fillun sporadike, unë e mbaj mend në Hade të Obiliqit ni, ka qenë ni ditë e kfjellët. U dëgjojke topi duke, krismat e topave edhe granatave, ne ishim në Prishtinë. Bile e mbaj mend që edhe misi (Mis Kosova) u zgjedhë në Grand Hotel në valën e atyne krismave. Aty janë vra tre djem, njani ka qenë i Istogut, ni student i fizikës, ni Mentor Dervishaj edhe dy tjerë. U shihke situata që është asi... mirëpo ish interesant, opiniononi mrena në Prishtinë ish që në Prishtinë n'qytet mrena s'ka me pasë diçka.

Mandej erdh situata që u blloku Prishtina, ma s'mujshje as me hi as me dalë. Ka qenë 3 prilli kur osht' rrethu Lagja Ulpianës. Aty kanë pru, përfundi soliterave ka qenë ni, ni, ni bunker si strehimore i thojshin. Atë ditë kanë pru, u shihke aty shumë ushtarë t'u zbraz municion e sene. Na kemi qenë n'banesë. Aty i kom pasë edhe miqtë në banesë. Të cilët e kanë shpinë atje rruga për Matiqan, po atje i zhvendosën ma herët. Ata u dashtë me lshu atje shpijen edhe me ardhë n'qytet mrena. Thojshin që n'qytet nuk bojnë asi.

Atëherë janë ardhë njësia speciale, kanë hy n'banesa edhe na kanë urdhëru, "Dhjetë minuta i keni me lëshu banesën". Tregojke ni fqi aty që e kem pasë në të dhetin kat, se unë kom qenë në të nantin kat, ai në të dhetin, nifar' Xhafer Hajdari. Tregojke mas luftës kur u takojshin veç i ka pytë, u ka thanë, "A me mbyllë derën a me lanë çelë?" Ai që ka udhëhequr njësinë speciale i ka thanë, "E mbyllë derën veç fmin tonë ki me gjujtë prej t'dhetit kat poshtë, me dorë tane". Domethonë nuk kemi mujtë as m'i mbyllë dyrtë, u dashtë m'i lanë hapt dyrt.

Na kanë tubu te fontana, t'gjithëve. Na kanë orientu kah spitalet, jo aty kah, kah Ulpiana për arsye se ata ishin t'u zbarku dika. Na kanë çu kah spitalet, nuk e dishim ku. U folke... sigurisht nja tre mijë veta se krejt banesat përreth aty. U folke që po na çojnë në stadium, u folke që po na çojnë në Serbi, a din,

na mes veti. Po na kanë çu në Stacion të Trenit. Në Stacion të Trenit aty kemi prit, shumë njerëz. Kur jem shku aty edhe pjesëve tjera të qytetit. Ka ardhë treni, kemi hip n'tren, jemi shku kah Bllaca. Treni osht' nalë në Fushë Kosovë, u nalë edhe ni vend tjetër.

Momentet ma t'vështira janë kanë kur u nalke treni se kish paramilitar jashtë që u sillshin të ngjyrosun, me ato shamijat, u sillshin. Ka pasë raste që janë hi n'tren mrena, i kanë bastis, i kanë nxjerrë njerëzit prej treni. Te na veç... nuk ka pasë aso raste. Ka prit treni domethonë gjysë ore aty edhe jemi shku për Bllacë, kufiri me Maqedoninë. Kur jemi shku në Bllacë, domethonë 3, 3 prilli që ka qenë, ka qenë ni mot me ni shi t'lehtë ashtu po i ftoft dhe kemi zbarku aty me çanta me çka kishim. Aty kishin qenë ta merrke menja krejt Kosova është aty.

Kish pasë baltë, baltë deri n'gu. E kishim ni fmi t'vogël, ni javësh, miku. Miku domethonë, nusja e tina kish lind ni javësh fmija ish. Se djali ish dy vjet, dy vjet e gjys. U dashke me improvizu nifar' najllani aty me... po s'kish as dru, s'kishe ku me kput degë se krejt i kishin kput degët njerëzit t'u u strehu. Aty kem nejtë. Ka pasë familje që ka nejt ni javë, ni javë n'atë baltë. Na nuk kem, s'e kem pasë atë fat. Na kanë thanë që me autoparlant që m'i nda burrat prej grave dhe ai ka qenë momenti ma i vështirë për arsye se u përhap ni lajm që burrat p'i kthejnë mrapa.

Na e analizum situatën tham ma mirë me pshtu dikush se kërkush. Janë nda. Domethonë shoqja jeme me djalë, nusja e mikut edhe ajo me djalë t'vogël edhe vjehrra janë nda. Kanë dalë ata janë hi n'rresht, kanë dalë. Na kemi nejtë mandej aty deri, ata kanë dalë dikund kah 11:00 i ditës ora. Kem nejt deri në 02:00 t'natës. Deri në 02:00 t'natës kemi mujtë me mrri mandej për me dalë. Me plot peripeci aty kemi dalë dhe jemi shku, na kanë çu në Stankovec. Ka qenë ni kamp. Stankoveci dy i thojshin se ai Stankoveci atje nuk i ka nxan ma edhe e bon ni kamp tjetër ma larg se Stankoveci ni.

Ata veçsa e kishin pasë improvizu dhe kem nejt aty. Pa e ditë ku janë gratë, ku janë anëtarë tjerë të familjes, nuk e dishim hiç. Nga aty kemi ikë prej atij kampit të Stankovecit dy bashkë me baballakun edhe mikun edhe tjetrin mik. Se gruja i ka dy vllazën. Kemi shku në kampin Stankoveci ni, t'u mendu që mos janë aty. Aty me mijëra njerëz. Kemi kqyrë në çdo shator, nuk kem gjetë. Kanë kalu me thanë gati edhe ni javë dhe në Kryqin e Kuq aty, ka qenë Kryqi i Kuq, ni letër kish ardhë prej shoqes tem, prej bashkëshortes që, "Ne gjendemi në Strugë".

Historia e tyne kish qenë kështu, domethonë kur i kanë marrë kanë dashtë m'i çu në Shqipni. Kur kanë shku aty me autobusa janë dalë ata të Strugës edhe i kanë nalë. Kanë thanë, "Jo këta dojmë m'i nalë këta ktu". Ishin strehu mirë, në ni familje shumë t'mirë të Strugës. Aty kem marrë vesh ku janë. Nga aty tani kem kontakti edhe me ta. Janë ardhë me na pa aty në kamp, i kanë pru ata të Strugës me veturë. Aty e kom pa djalin mas ni kohe, e kish pasë marrë malli shumë. Si fëmija ma. Kem vendosë të dalim prej kampi.

Na mujshim me nejt në kamp se i kishim paraqit emrat për me shku jashtë. Se secili kur shkojshim n'kamp ta bishin ni list të vendit ku po don me shku. Unë e kisha vllaun në Austri, kisha shkru në Austri. Kisha çikën e axhës, Dilën të cilën jom rritë me to e kom si motër, në Majami, kisha shku për Amerikë edhe e kisha shkru për Suedi. Se tri vende mujshe m'i specifiku. Po na nuk e pritëm. Se kur erdhën ata me shti djalin aty në kamp nuk ma merrke menja dhe ata të Strugës kishin pasë thanë që munden me ardhë me nejt ktu.

Kemi dalë, kemi shku jemi vendosë aty dhe patëm punë diçka në Shkup, për diçka. U kanë shumë interesant, në Shkup, se nuk kishim lidhje kurgjo për familjen në Istog. Absolutisht s'kishim kurfar' lidhje as kah janë, as qysh u bo. S'kisha lidhje as për motra që i kisha te dyjat në Prishtinë. Në Shkup kem pasë punë, nuk e di për çka, kam qenë me mikun tem edhe rasisht e kom pa motrën e madhe, motrën e madhe. Ajo kish qenë deri në ambasadë për me kqyrë mundësinë me shku te vllau në Austri. Se ajo ka qenë pa burrë, osht' qajo që i pat' vdekë burri dhe ka qenë veç me tre fmi. Jemi pa, jemi pa aty.

Ajo kish qenë e vendosur në Tenovë, nifar' katuni Tenovë komuna e Tetovës. Po flasim, ajo po thotë që, "Po flas me atë pronarin se i kanë edhe dy shpija që ai vllaznit i ka jashtë, i ka t'lira. A ishe ardhë?" Thashë, "Po". Puna e saj se kish pa bashkëshort veç me fmi. Atëherë ata kanë pranë dhe bashkë me grujen e me djalin nga Struga jemi ardhë në Tenovë. Jemi vendosë aty. Unë nuk kom, s'muj, domethonë nuk gjoj fjalë për me përshekru çfarë pritje na kanë ba.

Pritje jashtëzakonisht si për fmi, si n'sofër ai pronari që ka qenë aty, Muhamet e ka pasë emrin. E merrke djalin n'sofër në prehën t'vet. Pritje ma sikur n'shpi tonë. Po na i kishim ato ngarkesat psikologjike, çka po bohet, tek po bohet, bombardimet si po shkojnë, tek po shkojnë. Kem nejt domethanë në Tenovë dhe mas hyrjes së forcave të NATO-s edhe të KFOR-it në Kosovë jemi ardhë, jemi kthy. Bile ai na ka pru, zoti Muhamet na ka pru me veturë t'tij deri në banesë. Kem ardhë.

Kur kem hi n'banesë, banesa dera kish qenë e hapne, gjanat e shkatërrune të vjedhne shumica. Ni derë kish qenë mbyllë me çels. Se ajo dhoma ka qenë tri dhomëshe, ni dhomë e vogël, ni sallon edhe ni dhomë tjetër. Ajo dera ku kish qenë e mbyllne me çels n'derë shkrujke, "Policia". Mandej nuk guxojshim me çelë. Se ka pasë raste që u përmenke që e kanë minu ato dhe kur e ka çelë derën ka shpërthy mina. Nuk guxojshim për me çelë derën. Mandej kaloj ni kohë u dashke, e çela derën. E çela derën.

U shihke që aty kanë nejt policia dhe kanë bo punë t'kqija. U shihke që ajo osht' përdorë edhe për dhunime. Ni letër kish qenë me disa emra, me disa emra në tavolinë. Që atë letrën nuk du as ta kujtoj. U dasht krejt ato gjana m'i gjujt. Edhe kesi soji tani kem vazhdu mas lufte. Jemi kthy në objekte shkollore, kem vazhdu...

Anita Susuri: E rruga për me ardhë deri në Kosovë, qysh ka qenë?

Sami Shatri: Rruga u shihshin forca të KFOR-it, u shihshin vetura të prishuna që kishin mbetë në Bllacë aty, skej kufiri kishin mbetë. More me thanë nja 100 a 200 vetura që njerëzit i kanë lanë edhe kanë dalë. Ato kishin mbetë qaty n'qat' baltën u shihshin. Me t'thanë t'drejtën mu pak si m'pat' zanë makina. Ndoshta ishin edhe momente emocionuese, kom nejt si flejtun derisa kem mrrri te Prishtina. Kur kem mrrri në Prishtinë njerëz pak. U doke nifar' gjendje shumë e ranë, në përgjithësi e ranë.

Ashtu kur kemi hi në banesë, banesat shumë shpejt u mbushën me njerëz të ardhun nga viset tjera që kanë mbetë pa shpi. Po fatkeqësisht edhe me njerëz që kanë nuanë banesa, që kanë pasë banesat e veta po kanë ozurpu banesa. Ato ishin banesa të serbëve. Banesat në Ulpiane kanë qenë shumë banesa të serbëve. Ni gjendje jo e mirë. Ni gjendje të cilën nuk e kishim prit mas shlirimit. Shembull përpara ka qenë ni organizim mbeturinat nuk u gjujshin nga dritarja, i çojshim atje. Aty i hudhshin prej t'dhetit kat, të nantit kat keset me asi... nuk ishim msu me pa atë gjendje, pak e ranë.

Ujë nuk kish. Pompa të cilat e ngritnin ujë në kate t'nalta s'punonin. Rrymë ma shumë nuk kish sesa që kish. Gjendje jo normale. Mirëpo kur mendojshe që dikush ka humb anëtarë t'familjes edhe jo ni, për shembull, osht' rasti në komunën e Istogut tre djem ju kanë vra n'luftë te familja Dervishi. Ka pasë raste edhe ma t'rana si i Adem Jasharit. Rasti i masakrave tjera. Rasti i masakrës në Suharekë që unë e kom njoftë njanin që ka qenë asistent i ndërtimtarisë, ni Hajdin Berisha. I cili në atë masakren e Suharekës vritet me gru edhe me dy fmi. Njani ni vjeç, njani dy vjeç.

Prapë kur i kujtojshim ato, këto s'janë kanë për m'i përmend fare. Situatë emocionuese ka qenë kur kom shku në Istog për herë t'parë. Se familja, tani morëm vesh që familja janë në Shqipëri, kishin kalu atje me peripeti t'mëdha. Kur kom shku bari te dera e shpisë ish kanë i rritun përmi ni metër. Domethonë u dokshin në vende t'caktune ndonjë lopë duke kullotë ose... kur kom shku shpija e vllaut kish pasë pshtu pa u djegë s'e kishin pasë gjujt. Se i kanë gjujt me do far' si granata. E kur ka ra ajo aty e ka djegë shpinë. Ajo kish ra ni qosh t'shpisë u dishin gjurmët te dritarja që është nalë.

Shpija e mixhës ish pasë djeg me temel. Merre me mend, që ai që ka qenë nëpër burgje e asi. Kerrin e kalit ia kishin pasë djeg. Domethonë nga inati edhe kerrin e kalit e kishin pasë djeg. Aty ai krejt gërmadha ka qenë ajo shpi. Mandej ata janë kthy. Vllau i madh ka qenë në Gjermani, prej Shqipnie ka shku në Gjermani. U kthy ma vonë. N'atë shpinë tonë ni kusheri ka nejt aty dhe kësi soji ka përfundu kjo storie deri sot.

Anita Susuri: Zoti Sami, nëse keni edhe diçka për fund me shtu urdhnoni.

Sami Shatri: Jo, faleminderit. Kshtu ashtu po m'duket e zgjatëm pak. Unë kom shumë t'flas n'lidhje me këto ngjarje. Kryesisht këto ngjarje, meritë e ktyne ngjarjeve janë personazhë tjerë unë jom veç ni kallxues okular i ktyne ngjarjeve të cilat i përcjelli në mënyrë gojore te brezat që vijnë, është mirë të dijnë. Unë kisha me thanë shpesh here e kom pytë sidomos mixhën, mixhën Isë, se, "Për t'gjitha kto

vujtje që i ke pasë qysh e nin vetën?” Domethonë. Ai e jepke gjithmonë përgjigjen thojke, “Boll kom vujtë, boll kom hjekë”, thojke, “po hallall i koftë Sali Shatrit, vllaut tem”, thojke, “pse po ia boj hallall?”, Thojke, “se saherë u ndeshë me ta fitues u dalë”.

Domethonë kurrë s’kanë mujtë as me nxan, as të gjallë as qysh kanë kërku ata të vdekun. Unë i kom disa shënime këtu në Facebook që janë, ndoshta janë në interes për personalitete të ndryshme që kanë dhanë opinione të ndryshme që e kanë njoftë Sali Shatrin. Po e përmendi Sali Shatrin se personazh kryesor i krejt ktyne ngjarve osht’ ai. Prej tina buron gjithçka çka na folëm. Po prej tina buron edhe shumë çka në lidhje me personazhë tjerë që sigurisht ata mund t’i intervistoni. N’lidhje me Muhamet Shatrin, Profesor Doktor Muhamet Shatri i cili mirret në izolim me grupin e intelektualëve në vitin ‘89, që ka qenë, kanë qenë anëtarë i institutit të historisë, profesor doktor në kabinetin e Ali Hadrit që ka punu.

Naser Shatri, i cili e ka prap ni histori shumë t’bujshme. Xhafer Shatri edhe ai i burgosun politik. Dhe Shatrave tjerë që ne jem t’u e përmbledhë ni listë që sigurisht do t’del ni shkrim me ata të cilët ndoshta është numri mbi 100 që janë, kanë qenë t’burgosur, të përsekutun në mënyra të ndryshme po edhe t’vram. Meritë e posaçme që duhet me cekë është edhe kontributi i Fikret Shatrit, n’luftën e fundit edhe vllau i tina Izet Shatri që osht’ dëshmor. Që bjen dëshmor në betejën e Istogut që bjen n’prit, duhet me cekë. Atij shpirti dritë i past ba që e ka dhanë jetën për këtë liri që na e gëzojmë. E ndoshta, ndoshta, ndoshta nuk e kem meritë shumë n’bazë të asaj qysh po shkojmë.

Po e ardhmja ka me kanë patjeter. Se nuk ka qare, gjithë kjo vujtje, gjithë kjo punë e ardhmja do t’sjellë dritë, do t’sjellë dritë. Na ni kohë... andrra e t’gjithë dëshmorëve, andrra e t’gjithë dëshmorëve ndoshta do t’thoja me qindra vjet osht’ bashkimi i tokave shqiptare. Unë si përfundim, ata e kisha cekë, që asni zgjidhje tjetër nuk do t’qëndroj në Kosovë, nuk do t’qëndroj gjatë pos bashkimi i tokave shqiptare. Se ajo osht’ e natyrshme, ajo osht’ interes ekonomik tash ma së pari, osht’ interes politik.

Vetëm atëherë kombi shqiptarë do të qetësohet. Se kombi shqiptarë osht’ i ndam sikur ni trup i cili ju ka hjekë ni dorë, ju ka hjekë ni kamë dhe s’mund t’feksionoj. Se njerëzit çuditën, s’mund t’feksionoj normal ni trup që është sakat. Prandaj, krejt përpjekjet duhet t’shkoj me atë që ne t’jemi bashkë. Kur jemi bashkë ma ndryshe flet edhe Serbia edhe tjetër. Se jem ma shumë, jem ma t’fortë, jem ma t’organizun, jem ma t’zhvillun. Kjo është fundi që unë e kisha dhanë.

Pra, kur t’bohët n’atë aspekt... se vetëm ajo formulë ka me flejt, ka me nxan vend ktu. Le t’mundohen sa t’dojnë t’hujt, jo asociacioni. Nuk ka me zanë vend ajo për arsye se na me serb kem përvojë, kem përvojë. Ata e kanë politikën e tyne gjithmonë dhe nuk harrojnë që... unë jom shumë i bindur që me premtu dikush Serbisë, me i i garantu dikush Serbisë që Kosova kurrë s’bohët bashkë me Shqipninë, meniherë kish pranë.

Pse kish pranu? Se interesin ekonomik e ka, eksportin e ka në Kosovë, mallrat i shet e krejt. Po ajo gjithmonë e ka drojën e bashkimit të shqiptarëve. Pse e ka drojen? Se e din çka ka ba, i din krimet, i din t'gjitha ato dhe gjithmonë e ka drojën që shqiptartë kur t'forcohen shqiptartë nuk mundën ma, domethonë përfundon niherë e përgjithmonë loja me shqiptarë.

Anita Susuri: Ju faleminderit shumë për rrëfimin e ju!

Sami Shatri: Faleminderit juve për ftesën! Shumë faleminderit!